REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br 06/24
Nr. i fq. / Br. st -1-
Data: / Datum 17.01.2024
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS    KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

**Ju fton**

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **25 janar 2024 (e enjte) me fillim në ora 10:00.**
Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtrri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

**R E N D   D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 28 dhjetor 2023;
2. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve për periudhën janar – dhjetor 2023;
3. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për pagesën e shujtave ditore për zyrtarë të administratës së komunës;
4. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndarje të mjeteve financiare - Ndërmarrjes Publike Lokale "Përparimi" SH.A në Vushtrri;
5. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndarje të dekoratës "Nderi i Qytetit" për Heronjtë e Kosovës: Enver Zymberi (post mortum) dhe Afrim Bunjaku (post mortum);
6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për financim të shkollimit të fëmijëve të Heronjve të Kosovës: Enver Zymberi dhe Afrim Bunjaku;
7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit për KKSB-në;
8. Pyetje dhe përgjigje.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br 05/24
Nr. i fq. / Br. st -1-
Data: / Datum 17.01.2024
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

| | |
|---|---|
| **PËR:** | **Kuvendin e komunës** |
| **NGA:** | **Melihate Basholli Latifi** ____________<br><br>**Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë** |
| **PËRMES:** | **Sekretarisë së Kuvendit** |
| **TEMA:** | **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 17.01.2024** |

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **17 janar 2024** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve për periudhën janar – dhjetor 2023.
   ***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***
   ***Që Raportit t'i bashkëngjitet edhe realizimi i investimeve kapitale (nga të gjitha drejtoritë) dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

2. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për pagesën e shujtave ditore për zyrtarë të administratës së komunës.
   ***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***
   ***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

3. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndarje të mjeteve financiare - Ndërmarrjes Publike Lokale "Përparimi" Sh.a në Vushtrri.
   ***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***
   ***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

4. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndarje të dekoratës "Nderi i Qytetit" për Heronjtë e Kosovës: Enver Zymberi (post mortum) dhe Afrim Bunjaku (post mortum).
   ***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***
   ***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

5. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për financim të shkollimit të fëmijëve të Heronjve të Kosovës: Enver Zymberi dhe Afrim Bunjaku.
   ***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***
   ***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit për KKSB-në.
   ***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***
   ***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

*Me respekt!*

**REPUBLIKA E KOSOVËS** **KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI**

**P R O C E S V E R B A L**
**NGA MBLEDHJA E -XI- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 28 DHJETOR 2023**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën **10:10.***
Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:
Adnan Lahu, Agim Bregaj, Ali Januzi, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Faton Hyseni, Galip Audiu, Gresa Muli, Gentiana Rama, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nurie Halili ,Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Shkelzen Xhaferi, Spasoje Stefanoviq, Sylejman Meholli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

**Mungun:** Refik Maloku, dhe Nasuf Aliu**.**

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 33 anëtarë të kuvendit, kuorum i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës z. Shpëtim Zhegrova, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

**Në fillim të mbledhjes kryesuesja e kuvendit njoftoj se është bërë zëvendësimi i anëtarit të kuvendit ku në vend të z.Ilmi Azemi, është zëvendësuar kjo pozitë me z.Basri Menxhiqi.**

**Në vazhdim z.Basri Menxhiqi e dha betimin para kuvendit duke u bërë anëtar i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me drejta të plota.**

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**pasi i përshëndeti të pranishmit tha se nuk dëshiron të zgjatet shumë, meqë jemi në seancën e fundit për këtë vit fiskal, e do rendi dy-tri fjalë jo për të raportuar, po për t'ju ë falënderuar secilin prej juve si anëtarë të Kuvendit, sepse e patëm një vit vërtet ku patëm edhe sfida, patëm edhe vështirësi, patëm edhe debate, patëm edhe kritika dhe të gjitha këto i arsyetoj me qëllimin më të mirë, se ishin në interes të qytetarëve dhe ishit në përfaqësim të qytetarëve, ani pse shpeshherë Edhe kritikat ndoshta kanë qenë pa informata të bollshme, megjithatë e kanë arsyen e vete. Vërtet e patëm një vit bukur sfidues, që na përcollën në disa aktivitete që deri diku më prolonguan edhe proceset edhe projektet, po ma në fund ia dolëm me

një pasqyrë që do ta japim në fillim të vitit të ardhshëm me një raport detaj dhe do të shohim ku kanë qenë edhe pikat e forta, edhe pikat e dobëta, ku kanë qenë edhe sukseset, por ku kanë qenë edhe ngecjet. Patë vështirësi sepse për një periudhë kohore të hyrat e bartura u stopuan derisa ato u lëshuan. Sfida tjetër që na ka përcjellë ka qenë edhe një obligim që ka dalë nga kontrata kolektive, të cilën e kanë nënshkruar Ministria e Arsimit me sindikatë me Bashkimin e Sindikatës së Pavarur të Kosovës dhe në mënyrë që ta kursejmë buxhetin e komunës ose ta shpëtojmë atë që shpëtohet dhe t'ju dalim në përmbushjen e arsimtarëve në atë që është e drejtë e tyre legjitime, duke u bazuar në opinionin e Gjykatës Supreme që ka konfirmuar të drejtën e mësimdhënësve për pagesën e licencave dhe të inflacionit. Ne si komunë, nëse guxoj të shprehemi kështu, ndoshta jemi të vetmit në Kosovë që e morëm mbi vete, domethënë një rrezikshmëri përmes procesit të ndërmjetësimit por ia dolëm që në këtë vit fiskal të ekzekutojmë diku afër 70% të këtyre borxheve dhe komunës ia shpëtuam për mbi një milion euro që ato pare do të shpenzohen për investime tjera dhe dua t'i bëj të qartë opinionin e gjerë qytetarët e Vushtrrisë, veçanërisht mësimdhënësit se ne si komunë i keni proceduar me kohë të gjitha, ajo pjesë që ka mbetur e papaguar ka mbet për shkak të ekzekutimit në Ministrinë e Financave se ka qenë fundi i vitit dhe kanë pas aq shumë lëndë saqë vetëm prej, për neve, diku janë marrë mjetet ndoshta prej nëntëdhjetë projekteve, se nuk kanë qenë projekte dy-tri projekte, ku mundën me marrë shuma të mëdha , por janë marrë diku dy mijë, diku tre mijë, diku dhjetë mijë, dhe diku njëzet mijë. Megjithatë, ia kemi dalë në mbarë edhe pjesa tjetër që ka mbet vetëm me u ekzekutuar nga Ministria e Financave, ai ka kontaktuar dje me ta dhe mendon që edhe sot do të hapet mundësia për ekzekutim. Nëse jo, pjesën tjetër ekzekutohet tash në mënyrë domethënë prej janarit edhe do t'i marrin mësimdhënësit ato mjete. Jemi munduar me përcjellë një frymë pozitive bashkë me juve, në kohë që çdoherë unë si kryetar i komunës e kam qëlluar, Kurse që çdo herë kam qenë ndoshta në nivelin më të duhur por një ju siguroj që çdo lëshim që u bë nga ana ime nuk ka qenë i paramenduar dhe s'ka qenë i qëllimshëm Dhe kështu që, meqë jemi në fund të vitit, unë po dua edhe me ju falënderuar secilin prej juve si anëtarë të Kuvendit pa asnjë dallim, por të kërkoj edhe ndjesë për çdo lëshim që e kam bërë përgjatë këtij viti edhe në raport me juve, edhe në raport me qytetarët. Ajo pjesë që kam menduar që gjatë këtij viti do të bëjmë diçka kanë qenë shërbyesit civilë, se në të vërtetë tash kategorizimi i pagave në shërbimin profesional A tre, i kanë pagat shumë të ulëta, jashtëzakonisht të ulëta dhe jemi duke bërë analizën bashkë me drejtorin e thesarit dhe vitin e ardhshëm do t'i paraqes para juve në seancën e janarit propozimin për shujtat për shërbyesit civilë. E di që edhe në mandatin e kryetarit Bajram Mulaku është marrë një vendim, po patë mbet ashtu dhe tash në bazë të analizave që i kemi bërë, pak na duhet me u mobilizuar si qeveri komunale, m'i mbledh taksat pa i ngarkuar qytetarët, por ato borxh që janë duhet me u mbledhë, në mënyrë që me rritë të hyrat Vetanake, dhe prej fondit të subvencioneve, domethënë që fillojmë prej një janarit edhe për shërbyesit civil. Ndërkaq, prej 1 janarit fillon edhe menaxhimi i mbeturinave nga kompania që tash jemi aksionar 100% kompania “Përparimi” në pronësi komunale. Për këtë falënderoj të gjithë anëtarët e kuvendit për mbështetjen e ofruar për këtë kompani derisa të forcohet si kompani, na duhet të jemi bashkërisht edhe ta mbështesim, po edhe të jemi edhe kritikë Aty ku ka vërtet hapësirë për kritikë, sepse për ata dhe jemi këtu. Tash e kemi edhe diasporën, i kemi mysafirë, na e kemi filluar disa punë në sheshin e qytetit, po jemi munduar me i filluar punimet atëherë kur pengohen, ma së pakti se pa i pengu s'kemi me i lanë edhe qytetarët edhe ata, po jemi mundu ashtu dhe janë bërë punët të mira veç janë tu shkuar punimet si duhet. Unë ju dëshiroj mirëseardhje diasporës në qytetin e Vushtrrisë në familjet e tyre që t'i kemi çdoherë afër ashtu qysh kanë dhënë, qysh kanë kontribuar për familjet, për Vushtrrinë dhe për gjithë Kosovën dhe krejt në fund, më lejoni që secilit prej juve t'ju urojë gjithë të mirat për vitin 2024, ta keni shëndetin ju dhe familjet e juaja t'ju uroj edhe gjithë

qytetarëve të Vushtrrisë dhe diasporës, kudo që janë, ta kemi një vit të suksesshëm të jemi të unifikuar ato ku janë interesat e përbashkëta dhe të jemi kritikë atu kur duhet me kritikuar, por me i çuar proceset ma mirë e ma mbarë. Edhe një herë ju falënderoj të gjithë juve, anëtarë të kuvendit komunal, për kontributin e juaj që keni dhënë përgjatë gjithë vitit falënderoj edhe qeverinë komunale kryesuesen, nënkryetarin dhe të gjithë juve se për në perceptimin tim dhe bindjen time kemi pas një bashkëpunim të shëndoshë, një bashkëpunim të sinqertë.
**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-** pasi i përshëndeti të pranishmit tha se e ka shprehi çdo herë seancën e shikon në reprizë. Dhe atë që ka parë në seancën e kaluar, saktësisht në pjesën e dytë në minutën e 48 peroni që është punësuar, për incizimin e mbledhjeve e largon kamerën për mos me e pa qytetarët dëshmitë. Shpreson se kësaj radhe nuk e largon, kamerën nga fokusi fjala ka qenë për këtë foto që e kam marrë një paralele për ujitjen që u kon pika për kompaninë "Përparimi" kam marrë një paralel dhe kam thënë që nuk ka mundësi unë këtë kohë mu zhvillohet lulja në nëntor. Kur hina në detale dhe këqyra, se normalisht më të gjeta, e kemi pak problem, Edhe pasi në këtë shihet kryetari në teren duke vizituar rajon të tëra të vërshuara, e që i bie se nuk ka pasur nevojë për ujitje të luleve. Atëherë shtrohet pyetja: e kam përkrahë e kam bo statutin e kam përkrahë kryetarin dhe dy drejtoritë? edhe të Emergjencës, edhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Pika tjetër, foto tjetër që ma kanë fshehur nga kamera është për këta kamionë që thashë që nuk janë të regjistruar. Nuk kanë regjistrim. Që s'kanë regjistrim, nuk kanë as kontrollim teknik. Çfarë është më e keqja, kur kam hi në detale dhe ka kontrolluar, unë kam pa dhe i ka interesuar që shumë mjete në Përparim nuk kanë regjistrim as sot. Unë e pashë një rekomandim të KPF-ja një kërkesë për subvencion që ia kishte dhënë kompanisë Përparim për vitin 2024 me një shumë prej 190,000.00 €, besoj që ju falënderoj, juve që nuk e keni përkrahë. Nuk e keni përkrahë, sepse sipas mendimit tim në këtë korporatë ka shumë keqmenaxhim dhe keqpërdorim. Dhe marrësh një shembull për një kamion janë votuar në kuvend rreth 70.000.00 €, ndërsa kamioni ka qenë i prishtë por e njëjta kompani, edhe ka marrë tenderin për rregullimin e atij kamioni. Mos folum edhe për tjera sene që janë në këtë kompani duke u keqpërdorur. Unë publikisht e thërras hetuesinë dhe prokurorët të merren me këtë kompani, shumë besoj që ka fakte, që të merren me këtë kompani hetuesia. Dhe krejt në fund, pata një kërkesë për këtë çunin që u punësua rishtas, Duaje punën! Punon si ora më e mirë që është, po mos lejo me të kurdisë askush, sepse të bie vlera. Kur të bie vlera, bie edhe çmimi. Ju faleminderit!
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-** pasi i përshëndeti të gjithë të pranishmit duke uruar për fund vite deklaroi se nuk dua të zgjas dhe nuk dua të bëj polemika me askënd Dua t'i uroj qytetarët e Vushtrrisë për 2024 Të gjithë ju, anëtarë të Kuvendit, edhe ekzekutivë, duke u uruar që vitet në vijim të jenë më të suksesshme për komunën tonë pavarësisht dallimeve partiake, duke uruar që ekzekutive dhe kryetarit të respektojë opozitën më shumë në përfaqësim dhe në komunikim për problematika tjera për buxhet dhe për të tjerat do të bisedojmë janar. Kam shpresuar shumë që me ardhjen e mikut tim si drejtor i Prokurimit, buxheti do të shpenzohet dhe do të mbërrijë aty ku duhet meqë buxheti është shpenzuar, po kryetar për këtë punë, fatkeqësisht s'mund me ju falënderuar mikut tonë, z.Azemi, po për përmbaruesit privat në këtë rast po për këtë çështje diskutojmë në janar. Faleminderit shumë!
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-** pasi i përshëndeti gjithë, të pranishmit me urimin për 2024 deklaroj: kjo është seanca e fundit e Kuvendit Komunal për vitin 2023 dhe duke qenë e tillë kjo shënon një mundësi reflektimi se si ishte qeverisja Idrizi gjatë këtij viti në pika të shkurtra? Le të fillojmë me ekonominë, financat dhe zhvillimin lokal. Edhe viti 2023 ishte vit i ngecjes së zhvillimit ekonomik dhe dështimit të menaxhimit të suksesshëm të financave. Sikurse edhe në vitin 2022 po ashtu edhe këtë vit miliona euro shkuan në suficient të pa shfrytëzuar, kurse mbi 130

projekte nuk u nisën fare deri në 30 shtator 2023, duke qenë komuna me performancën më të dobët në Kosovë në këtë aspekt. Të vetmet shpenzime që shënuan shifra rekorde të realizimit ishin drekat, ngase viti 2023 ishte një vit plot luks për qeverisjen lokale me paratë e komunës dhe qytetarëve. Si ishte bujqësia dhe zhvillimi rural? Edhe viti 2023 ishte vit për t'u harruar nga bujqit e komunës sonë, për sa i takon mbështetjes nga qeverisja Idrizi. asnjë mjet pune, asnjë makineri, asnjë fidan, asnjë farë asnjë zgjerim i rrjetit të ujësjellësit apo furnizimi me fara ose plehra artificiale nuk u ndanë gjatë vitit 2023 nga Drejtoria e Bujqësisë nën qeverisjen Idrizi. Madje gjatë vitit 2023 nuk i morën as pas dy viteve akoma as serat shumë përfitues nga projekti i bashkëpunimit me islamic reliefin. Tutje si ishte arsimi dhe edukimi. Nuk ka sektor tjetër, si ai i arsimit, që simbolizon mashtrimin e kryetarit Ferit Idrizi që në fushatë premtonte se do të reformojë sistemin arsimor të komunës sonë me planin e tij special, siç i quante Por, ç ‘është e vërteta, viti 2023 shënoi emërimin e drejtorit të tretë në këtë drejtori, në dy vite qeverisjes të Idrizi. Përtej kësaj situate skandaloze, arsimi ka vuajtur nga mashtrimi përmbajtjesor i së cilës në investime kapitale gjithandej në shkollat e komunës së Vushtrrisë. Rasti më eklatantë ishte rasti i shkollës së fshatit Smrekonicë, por edhe sa të tjera pritet të bëhen publike në vazhdim të vitit të ardhshëm Shëndetësia dhe mirëqenia sociale. Nëse arsimi simbolizon mashtrimin elektoral të qeverisjes Idrizi, pa dyshim që shëndetësia shënon simbolin e degradimit masiv Kryetari Idrizi shkatërroi shëndetësinë dhe rrezikoi shëndetin e mirëqenien e qytetarëve, në dy vite sa për ta ruajtur raportin me ish-drejtorin Rashica, duke e pritur drejtorin derisa të lodhet, kur u lodh drejtori dhe u tërhiq vetë, ngase performanca e tij ishte skandaloze nuk kishte qytetar , madje as vetë Ferit Idrizi që nuk e shihte. Urbanizmi dhe planifikimi, bashkë me Kadastrin. Gjatë vitit 2023 krejt për çka mbahet mend këto drejtori është se miliona euro shkuan në suficit dhe në dhjetëra rrugë që ishin planifikuar për t'u asfaltuar, nuk u asfaltuan. E gjithë energjia e kësaj Drejtorie, bashkë me atë të Kadastri, ishte ti përmbushuni apetitet e ndërtuesve të lidhur me partinë, të cilët e kanë shndërruar Vushtrrinë në kantierë betoni e banesa, në të cilat nuk ka nevojë për ashensorë, por me mundësi të qarkullimit prej banese në banesë, prej katit në kat përmes ballkoneve të këtyre banesave për shkak të shkeljes flagrante të lejeve dhe kritereve të lejeve të ndërtimit. Shërbimet publike mjafton të përmendim që gjatë vitit 2023 asnjë shtëpi, asnjë lagje, asnjë fshat që aktualisht nuk ka rrjetë të ujësjellësit nuk u kryqën në rrjetin e ujit të pijes dhe mijëra euro për këtë projekt, shkuan suficit. Kultura dhe Sporti Mjafton ta kujtojmë faktin që kjo drejtori deri më 30 shtator 2023 ka shpenzuar zero euro në investime kapitale për ta kuptuar se si ka qeverisur kryetari dhe drejtoria në këtë sektor. Sfida më e madhe e kësaj drejtorie gjatë vitit 2023, sikurse gjatë vitit 2022 ishte si t'i përmbushte apetitet e OJQ-ve të drejtuar nga zyrtarë të partisë e besa edhe vetëqeverisjes dhe koalicioneve për sukseset e sportit dhe të klubeve, as që u diskutua ndonjëherë se çfarë po ndodh. E fundit, siç është qershia mbi tortë: çfarë bëri kryetari, Idrizi me ndërmarrjen Lokale Përparimi. Qëlloni se çfarë bëri! Kositi plotë 60 hektarë tokë gjatë muajve të dimrit, sipërfaqe gjelbëruese dhe me këtë janë shpenzuar gjashtëdhjetë mijë euro dhe kryetari ka paguar një çmim të kripur. Për (9) nëntë euro për ari për kositje. E dini sa është çmimi i tregut për një ari kositje?

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-** pasi i përshëndeti të pranishmit tha se meqenëse jemi në seancën e fund vitit, pra e fundit për vitin 2023 shfrytëzoj nga rasti që të gjithë juve që jeni prezent, po ashtu të gjithë qytetarët e Komunës së Vushtrrisë dhe më gjerë, t'ju uroj vitin e ri 2024, me shpresë dhe dëshirë që ky vit të jetë vit i shëndetshëm dhe i suksesshëm për të gjithë! Meqenëse jemi në seancën e fundit, unë dua t'i them disa fjalë për qeverisjen e kryetarit Ferit Idrizi dhe Qeverinë Komunale në Vushtrri për vitin 2023. Çka e karakterizoi qeverisjen komunale në Vushtrri në këtë vit? E para është ndërrimi i shpeshtë i drejtorëve komunalë dhe mossuksesi i tyre, që nënkupton edhe mossuksesin e kryetarit të komunës dhe Qeverisë komunale; ndërrimi i

drejtorëve të arsimit shëndetësisë, i prokurimit e tjerë. Edhe pse kryetari i Komunës, Ferit Idrizi, premtoi se në vitin 2023 të gjithë qytetarët e Vushtrrisë, do të kenë ujë të pijes, një gjë e tillë nuk ndodhi dhe shumë lagjen e fshatra të Vushtrrisë as në vitin 2023 nuk patën ujë për pije. Gjatë vitit 2023 Drejtorinë Komunale të Arsimit e udhëhoqën dy drejtorë në periudha të ndryshme kohore. Asnjëri prej tyre nuk erdhi nga fusha e arsimit asnjëri prej tyre nuk ka mbajtur asnjë orë të vetme mësimore me nxënës, prandaj nuk pati rezultate të mira as përmirësim në sistemin edukativo-arsimor komunën tonë dhe lirisht mund të themi se emërtimi i drejtorëve të drejtorive komunale të arsimit të personave, të cilët nuk vijnë nga fusha e arsimit, është nënvlerësim përreth njëmijë mësimdhënës të komunës sonë dhe si pasojë e saj kemi pasur shumë konkurse të anuluara dhe shumë projekte të parealizuara në shkollat e qytetit tonë Në investimet kapitale në infrastrukturë, rrugët e asfaltuara janë të kualitetit të dobët shumë rrugë të përzgjedhura për asfaltim ose kanë mbet në gjysmë, ose nuk janë asfaltuar fare, siç janë rastet në Stanoc të Poshtëm, në Stanoc të Epëm dhe rasti më eklatant në Ceceli-i është rasti i rrugës “Mon Përçuku”, e cila pasi është përgatitur për asfaltim në muajin dhjetor, e njëjta nuk është asfaltuar dhe në bazë të informacioneve të sigurta që i kemi Njësia e Krimeve Ekonomike në Mitrovica ka intervistuar disa persona nga komuna për të vërtetuar se pse kjo rrugë nuk është asfaltuar, kurse në njëjtin fshat, pra në Ceceli, janë asfaltuar disa rrugë, në të cilat janë disa shtëpi, por të cilat nuk banon askush. Po rrugët e rendit të parë dhe për të cilat është dashur të intervenohet me zhavor, as që bëhet fjalë. Shumë prej këtyre rrugëve janë gjendje të rëndë dhe të vështirë dhe vështirë të kalueshme dhe nuk është bërë asgjë në këtë drejtim. Si qeveri komunale keni dështuar në inkasimin e mjeteve të pronave komunale të dhëna në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë si në tokat bujqësore, ashtu edhe në lokalet afariste.

**Mentor Hasani, anëtar i kuvendit-** pasi i përshëndeti të pranishmit dhe qytetarët e Vushtrrisë, meqenëse se është seanca e fund vitit deklaroj me sa vijon: gjatë këtij viti kemi pas shumë sfida, shumë punë, shumë angazhime. Kemi pas edhe situata të rrezikshme për shtetin tonë ku si pasojë e kemi një Policë të Kosovës i cili ka humbur jetën në mbrojtje të rendit në veri të Republikës Sonë heroi Afrim Bunjaku, u prehet në paqe ! Në asamblenë komunale kemi kaluar një vit ku seancat kanë qenë si vendime, disa me vota unanime, disa me shumicë e votave e të pranishmëve, ndërsa disa vendime kanë dështuar. Kjo vërteton se ky Kuvend, këta deputet, kanë vendosur sipas vendimit të tyre dhe ka mbizotëruar demokracia. Viti i ri 2024 po hyn , por, fatkeqësisht, disa nga meritoret kryesor të lirisë së Kosovës nuk kanë mundësi ta gëzojnë këtë festë: ish-kryetari Hashim Thaçi, ish-krye parlamentarët Jakup Kazniqi e Kadir Veseli ish-deputeti Rexhep Selimi dhe të të tjerë, që padrejtësisht gjenden Burgun e Hagës. Uroj që kjo të jetë festa e fundit për familjet e tyre dhe për krejt Kosovën që e festojmë pa ta. Si shef i grupit parlamentarë të Parisë Demokratike shpresoj që viti që do të hyjë do të jetë vit i punës vit i realizimeve të mijëra projekteve, me shumë angazhime dhe bashkëpunim në realizmin e plotë të gjitha projekteve filluara në qytetin tonë. E di se ka ekzistuar skepticizmi ka ekzistuar dhe ekziston gjithmonë, por t'ia lëmë një kohë dhe të presim realizimin e projekteve madhore që i kemi filluar në qytetin tonë, ku me shumë vëmendje do t'i përcillmi ecurinë e kualitetin e tyre.

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-** tha se me qëllim të sqarimit para qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë ndjenë për obligim të flas, përndryshe do ishte më keq sikur mos të fliste për faktin se po krijohet përshtypja se nuk është bërë asgjë për gjatë këtij viti e që kjo nuk është e vërtet, domethënë nëse prekim bujqësinë për herë të parë ka pasur subvencione më shumë se çdo herë dhe për herë të parë ato subvencione është bërë një ndarje e drejtë, nuk ka pas asnjë ankesë dhe i ka parapri një diskutim publik me të gjitha përfaqësuesit e këtyre kulturave bujqësore, domethënë me fermerët. Dhe si rezultat për herë të parë e kemi subvencionuar qumështin me pesë centë për

litër madje nuk e kemi kategorizuar ashtu qysh e kategorizohet në bazë të sasitë së yndyrës, po të gjithë kanë qenë përfitues dhe asnjë ankesë nuk ka pas, se aty nuk ka pas dallime partiake kush prodhon qumështin, ka përfituar  nën dy i kemi subvencionuar bletët për koshere me katër euro janë subvencionuar delet, i kemi subvencionuar dhitë, madje këtë vit i kemi subvencionuar bollicat si një specie në zhdukje me njëqind euro për kokë? Arsyeja pse nuk kemi blerë makineri, se qytetarët kanë përvoja shumë të hidhura prej të kaluarës, sepse i kanë marr u kanë dhënë grave të veta. Prandaj nuk kemi dashtë me shti një konkurrence të tillë, po kemi dash me ju dhënë të gjithëve. Tjetër 273 sera, unë e di që procesi ka shkuar jashtëzakonisht mirë, edhe është monitoruar, domethënë edhe  çështja e  tyre, ka pas dëme për shkak të erarëve  të fuqishme që kanë ndodhur këto ditë po është normale, ka dalë Komisioni, ka bërë vlerësimin e tyre, dhe raporti do të vjen në Kuvend, për diskutim dhe aprovim. Sa i sa i përket arsimit, sinqerisht, që i besojnë gjithë mësimdhënësit, pa dallim partie, se ata i shoh si mësimdhënësi edukues të gjeneratave, e nuk i shoh si anëtarë të partive politike por ju kemi përkushtuar jashtëzakonisht shumë. Nëse ndonjëherë janë nda pak bursa, me një vlerë të bursës katërqind euro, këtë vit ne e kemi rrit numrin e tyre nga shtatëdhjetë e pesë sa kanë qenë i kemi rrit në njëqind dhe e kemi tejkaluar edhe Universitetin e Prishtinës, sepse ata kanë ndarë pesëqind euro bursë, ndërsa ne e kemi rritë këtë vlerë të burës gjashtëqind euro. Për arsimin profesional, programin modular të trajnimeve deri në gjashtë muaj, njëmbëdhjetë profile profesionale të rinjtëve dhe të reja i kanë kryer në qendrën gjermane në Diakoni, ku ne kemi qenë sponsoruesi kryesor dhe shumë prej atyre të rinjveve dhe të rejave janë punësuar në  ndërmarrje disa i kanë filluar bizneset e veta. Spikësin ka qenë tu funksionuar për shkathtësi të buta, na e kemi rritë numrin edhe aty, këtë vit ka qenë pa kufij. Ju kemi dhënë shpërblime të gjithë nxënësve që kanë marrë pjesë në garat e diturisë, por herë të parë kemi organizuar, garat përmes sistemit digjital. Ndërsa  rezultati më i madh për mësimdhënësit është që ju tregova që asnjë kryetar komune nuk ka marrë përgjegjësi me i hi sfidës për me paguar obligimin që vlen prej kontratës kolektive. Po ju tregoj edhe një, se, u përmend puna e shpenzimit, të buxhetit. Veç po ju tregoj edhe një kur e kam marrë, detyrën e kryetarit të komunës, kjo ka ndodhë, në vitin 2021,  ka dalë Raporti i auditorit me kualifikime me shumë të gjetura, por ka qenë vetëm 55%, shpenzimi dhe kjo përqindje ka ardhur falë këtij përmbaruesit që ju po e përmendni. Po ashtu njoftoj se përmes menaxhereve të kontratave i ka njoftuar operatorët ekonomik për pagesat për shkak se komuna ka hy në obligime nga kontrata kolektive e arsimit, dhe këto pagesa për firmat do të stopohen për një periudhë të shkurtër. Për dallim nga viti 2021 kur ishte gjendja e njëjtë me financimin e këtyre obligimeve tani shpenzimi i buxhetit ka shkuar deri 94%. Sa u përket drejtorive komunale, ndërrimit të drejtorëve nuk garantoj që s'ndërroj drejtoritë në vazhdim të mandatit. Qëllimi është suksesi veç po  ju tregojë diçka. Të gjithë shërbyesit civilë që punojnë brenda këtij objekti komunal nuk kanë pasur kushte minimale për punë as nxemje dhe kushte higjienike në banjo, dhe këto kushte janë afruar nga qeverisja e tij. Sa i përket Asfaltimit të rrugëve, po ju them shumë sinqerisht, mundem me iu argumentuar me  video, e kemi bo shpimin. Çdo qytetar që ka pretendime që ka jo kualitet dhe projekti nuk ka shkuar sipas kontratës është bërë shpimi dhe janë evituar defektet. Lidhur me shujtat për shërbyesit civil aty do të futen përpos tyre edhe zjarrfikësit dhe punëtorët e NPL. Përparimi.

**Melihate Basholli-Latifi** –njoftoj se kemi  dy pika shtesë të cilat na janë ë kthyer prej ministrisë për të bërë përmirësimet e nevojshme. E para Është rregullorja për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale. Ndërsa e dyta është propozim-vendimi për hartimin e Planit Zhvillimor komunal  për periudhën 2024 -2032 të njëjta duhet të futen në rendin e ditës për rishqyrtim dhe aprovim.

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-** në emër të Grupit Kuvendar të Lëvizjes Vetëvendosje, propozoi që të futet në rendin e ditës propozim-vendimi për ofrimin e mbështetjes financiare për

anëtarin e kuvendit z.Nasuf Aliu i cili kohët e fundit ka pasur probleme serioze shëndetësore, propozoi ti ndahet shuma prej 3000 € për mbështetej në trajtimin e sëmundjes. Kërkoj pa dalim partiake të mbështet ky propozim.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**njoftoi se z.Nasuf Aliu e ka vizituar dhe pasi e ka parë gjendjen e tij i ka ofruar një përkrahje financiare prej 900 € me vendim të tij. Prandaj ai e përkrah propozimin që ti ofrohet ndihmë por le të mbetet në vitin 2024 sepse tani buxheti është përmbyllur.
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**Meqenëse jemi tek rendi i ditës në emër të Grupit Kuvendar të Lëvizjes Vetëvendosje propozoj një pikë të rendit të ditës, kjo është propozim-vendim për subvencionimin e qirasë prej njëqind për qind të shumës së kontratës për bizneset që operojnë në zonën e sheshit të qytetit, të cilat janë të prekura nga zhvillimi i punimeve dhe kjo të vlejë nga data 01 nëntor 2023 deri më datën 31 dhjetor 2024, si dhe bizneset që kanë në shfrytëzim me qira lokale afariste pronë e komunën së Vushtrrisë, t'i lirohen nga pagesa e qirasë për periudhën kohore 01 nëntor 2023 deri më datën 31 dhjetor 2024. Arsyetim, siç jemi në dijeni, në muajin e nëntor në qytetin e Vushtrrisë kanë filluar punimet për ndërtimin e sheshit të qytetit, i cili projekt do të zgjasë së paku dy vite, e ndoshta edhe më shumë dhe i ka shkaktuar dëme të mëdha bizneseve dhe lokaleve afariste, që operojnë në këtë pjesë të qytetit, bazuar në këto fakte, shumë biznese po kanë vështirësi për të mbijetuar dhe zhvilluar veprimtarinë e tyre, andaj Grupi i Kuvendar i Lëvizjes Vetëvendosje del me propozimin që e ceka më parë.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-** njoftoj se i ka vizituar secilin biznes veç e veç, që operojnë në sheshin e qytetit ku po ndërtohet parkingu nëntokësor, dhe i ka njoftuar ato biznese që nga data pesëmbëdhjetë nëntor kur kanë filluar punimet dhe përgjatë kohës sa zgjatin punimet, do t'ua paguajmë qiratë. Kështu që propozimi s'ka nevojë. Por këtë vendim Pra, këtë vendim e marrim pas një analize në fillim të vitit fiskal, sepse jemi në fund të vitit fiskal. Prandaj shtoj se apeloj që të nxirret një rekomandim për tu bërë një analizë financiare për ofrimin e ndihmës për këto biznese për vitin 2024.
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**tha se kur e propozoj këtë pikë të rendit të ditës, natyrisht duke e ditë që ne veç edhe nesër jemi në një ditë punë në vitin 2023 dhe jemi të vetëdijshëm që nuk ka mundësi t'ju ndihmohet tash, sepse edhe nëse merret vendimi ato janë procedurat për të cilat dihet afatet kohore që janë në fuqi. Pra, qëllimi është që ky vendim propozim-vendim të zbatohet në vitin 2024 dhe mendoj që ë të gjitha bizneset që operojnë në këtë pjesë të qytetet janë të prekura nga punimet që janë duke u bërë, nuk është propozim popullist është kërkesë e bizneseve, bizneset kanë nevojë për ndihmë, prandaj kërkoj që propozimi im në emër të Grupit kuvendar të Lëvizjes Vetëvendosej të hedhet për vendosje kur të vijë radha të hidhet në votim dhe kisha kërkuar nga të gjithë asamblistët, kolegë ta përkrahim, sepse bizneset vërtet janë në gjendje të rënd.
**Adnan Lahu anëtar i kuvendit-** me të vërtetë pata dëshirë që kjo seancë e sotit me kaluar në një atmosferë pak më festive po fatkeqësisht edhe nga ana e PDK-së nga kryetarit, edhe nga ana e Vetëvendosjes po shprehet vetëm populizëm që cili i pari me i marrë merita, cili po del më mirë në foltore të qytetarët edhe kush po e thotë fjalën e fundit keq kryetar, po thua nëntor iu kam premtuar, ke pas kohë me vepruar prej nëntorit deri tash me marrë këtë vendim. Nëse ke marrë vendim, atë vendim ne mundemi me pa, sepse ai duhet të jetë publik. Po ashtu edhe propozimi i Lëvizjes Vetëvendosje është thuajse tejet popullist, duke e pas parasysh që jemi në fund të vitit fiskal dhe e dimë që dje është mbyllë buxheti, megjithatë qytetarët janë të vetëdijshëm dhe e shohin këtë mënyrë të komunikimit të mendojmë, vërtet edhe realisht se si mundim t'i ndihmojmë qytetarëve, kur kanë telashe dhe probleme dhe mos jo me këso forma, se me të vërtetë nuk na ndihmojnë.

**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-** E nderuar kryesuese, Nënkryetarë, Drejtorë të drejtorive, Kolegë deputetë, unë para miratimit të rendit të ditës i kam dy vërejte, zonja kryesuese Vërejtjen e parë e kam te plani i punës së Kuvendit dhe kërkoj që të bëhen dy ndryshime për muajin mars, që është planifikuar para miratimit të rendit të ditës. Ndryshimi konsiston tek raporti për punën e Ndërmarrjes Publike "Përparimi", të bëhet raporti jo nga Drejtoria për Shërbime Publike, por nga Komisioni Aksionar i kësaj ndërmarrje ndërsa te raporti i ndërmarrjes regjionale, në vend raporti, të jetë informatë e ndërmarrjes publike regjionale, sepse nuk raportojnë ata, po informojnë Ndërsa, sa i përket propozimit të anëtarit të Lëvizjes Vetëvendosje për mbështetje të biznesit në Bulevardin, Adem Jashari, të jeni të bindur, nganjëherë atë e habitë fakti se disa anëtarë të kuvendit aq shumë i dojnë biznese por kjo është vetëm me fjalë dhe për të qitur pluhur syve qytetarëve dhe bizneseve sa që dalin qesharak por realisht në këtë aspekt ai propozoj që të formohet një komision i cili fillimisht duhet e kemi listën e të gjitha bizneseve, çfarë veprimtari kryejnë, dhe të vlerësohet gjendja e secili biznes në mënyrë individuale.

Në vazhdim kryesuesja e kuvendit i hodhi në votim në mënyrë individuale pikat e propozuar në të ndryshme dha atë me sa vijo:

Kuvendi me vota "*unanime"* e procedoj në rendin e ditës rishqyrtimin Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale të Komunës së Vushtrrisë.

Kuvendi me vota "*unanime"* e procedoj në rendin e ditës Rishqyrtimin e vendimit për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2024-2032.

Kuvendi me vota "*unanime"* e procedoj në rendin e ditës propozim-vendimin për ofrimin e mbështetjes financiare për shërim për z.Nasuf Aliu.

Kuvendit me *19 vota "për" 1 votë "kundër"* e procedoj në rendin e ditës propozimin për ofrimin e ndihmës financiare për bizneset që operojnë në sheshin "Adem Jashari" vendi ku po ndërtohet parkingu nëntokësor.

**Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me vota "unanime" aprovoi këtë:**

**R E N D  D I T E**

**1.** Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 27-28 korrik vazhduar më datën 30 nëntor 2023;
**2.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më 30 nëntor.2023;
**3.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft-Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2024;
**4.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft-Planit të Punës së Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2024;
**5.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për lirimin nga taksa për shfrytëzimin e hapësirës publike në hollin hyrës (korridorin qendror) të Komunës për më pak se një vit;
**6.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënien në shfrytëzim për vitin 2024;

**7.** Shqyrtimi i Informatës për shërbimet sociale dhe të asistencës në Komunën e Vushtrrisë;
**8.** Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit të Komisionit lidhur me shfrytëzimin e pronës komunale ZK-Gracë;
**9.** Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit të Komisionit lidhur me shfrytëzimin e pronës komunale-tokat bujqësore në Komunën e Vushtrrisë;
**10.** Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit të Komisionit lidhur me shfrytëzimin e pronës komunale-lokaleve afariste-kiosqeve;
**11.** Shqyrtimi i raportit të Komisionit të aksionarëve të Kompanisë Regjionale "Uniteti";
**12.** Rishqyrtimin i Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale të Komunës së Vushtrrisë;
**13.** Rishqyrtimi i vendimit për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2024-2032,
**14.** Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim-vendimit për ofrimin e mbështetjes financiare për shërim për z.Nasuf Aliu;
**15.** Shqyrtimi i propozimit për ofrimin e ndihmës financiare për bizneset që operojnë në sheshin "Adem Jashari" vendi ku po ndërtohet parkingu nëntokësor.
**16.** Pyetje dhe përgjigje.

**1.** Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 27-28 korrik vazhduar më datën 30 nëntor 2023;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota "unanime", aprovoi procesverbalin nga mbledhja rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 27-28 korrik vazhduar më datën 30 nëntor 2023.**

**2.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më 30 nëntor.2023;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota "unanime", aprovoi procesverbalin nga mbledhja rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datën 30 nëntor 2023.**

**3.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft-Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2024;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota "unanime" aprovoj Planin e Punës të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2024.**

**4.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft-Planit të Punës së Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2024;

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-** tha se plani i punës të kryetarit të komunës realisht, është njëra prej pikave më të rëndësishme sepse pasqyron punën njëvjeçare të kryetarit të komunës. Mandej reflekton punën dhe aktivitetin që kanë sjellë drejtoritë, secila sipas dikasterit që drejton edhe përbërjen e vetë punës. Mirëpo, kryetari në këtë plan në asnjë faqe nuk ka paraqitë planin personal të punës, sidomos tek pjesa premtime që i ka pas. Po kur e përmenda mashtrimin e

kryetarit në arsim,  sepse e dimë çka ka fol për arsim edhe sektorët e tjerë Kryetari duhet me u ballafaquar me veten në mënyrën e atë se çfarë ka premtuar gjatë fushatës dhe çfarë realizon tani. Në këtë plan është dashur të figuroj se  çfarë ka realizuar kryetari në vitin 2022, në 2023 edhe çfarë ka për të realizuar prej projekteve për vitin 2024 kjo duhet të jetë është logjika. Por, në qoftë se Kryetari ka vendosur me i shpallë debat e fushatë e krejt ato që i ka premtuar sa për konsum elektoral dhe nuk ka plan me iu përmbajtur premtimit që i ka dhënë. Unë bashkë me subjektin tim politik, do t'ia kujtojmë, në fund edhe të viti 2024 , ose edhe në vitin 2025 zbulojmë një zgjedhje, listën e tij të gjatë premtimeve  të cilat i ka bërë e të cilat në asnjë moment nuk po tregon gatishmëri me i zbatuar. Për shembull, një prej premtimeve të tij që e ka  pas të zëmë në shëndetësi, do të ofrojë shujtë të ngrohta dhe kjo për profesionistët shëndetësorë. Janë ftoh, krejt ato shujta? Kanë qenë edhe planifikuara kiflet, në arsim  Pra, plani i punë është për të treguar në detaje se çfarë ka për të bërë dhe cilat projekte konkrete do të realizohen. Ku janë premtimet  elektorale të kryetarit? Sa janë realizuar? Çka kanë për tu realizuar në vitin 2024,? nga krejt këto që e shohim në planifikimet e drejtorive specifike se çka kanë realizuar, kurse në raport me premtimet që i ka bërë kryetari, nuk kemi asgjë të përfshirë në këtë plan të punës.
**Fatmire Cecelia anëtare e kuvendit-** tha se meqenëse jemi tek pika në rendit të ditës,  plani i punës i kryetarit të komunës, ashtu qysh deklaroj para folësi, ky nuk është një plan i punës së kryetarit, por një plan i punës i drejtorive komunale. E ka analizuar planin,  pothuajse është komplet, copy-past planit të kaluar nga të gjitha drejtoritë, bile jam mundu me gjetë diku ndonjë ndryshim por është tërësisht plani i njëjtë, madje tek shërbimet publike kanë harruar me ndryshuar vitin. Strategjia për realizimin e të mirave, të planifikuar për vitin 2023, në faqe 88-91 planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2023, tek Drejtoria e Shërbimeve Publike kishin harru me ndërruar vitin.  Tjetër çka desha me e cekë tek ky plan i punës të drejtorive komunale,  çka bie në sy është tek Drejtoria e Shëndetësisë, tek Shtëpia e Komunitetit në Vushtrri, tek pika gjashtë citoj: organizimi i aktiviteteve të lira, për punën ekipore me rezidentë, bëhet fjalë, për shtëpinë rezidenciale por për shkak të gjendjes aktuale, që jemi pa veturë, nuk kemi bërë aktivitete, domethënë jashtë institucionit dhe nuk kemi planifikuar aktivitete për vitin 2024. Po kërkoj nga Drejtori i Shëndetësisë të siguron një veturë, për Qendrën Rezidenciale duke pas parasysh kategorinë e rezidentëve ku  nganjëherë ndodhin edhe sëmundje atyre personave gjithçka mund të ndodhë nga ata persona, me iu u siguruar një veturë derisa të  parashihni të arsyeshme me ja u blejë një veturë. Diçka tjetër që desha të potencoj tek Drejtoria për Kulturën e Rini dhe Sport  tek pika 81-82, konkretisht pyeti drejtoreshën me çfarë procedura dhe me kë është koordinuar, për dhënin në shfrytëzim Kullën e Zejnullah Begut në fshatin Balencë si dhe për dhënin në shfrytëzim objektin e Hamamit të Qytetit Gazi Ali Begut në Vushtrri, me kë jeni koordinuar për dhënien në shfrytëzim të këtyre, objekteve pasi që, ne nuk jemi pronarë të këtyre objekteve, janë institucione tjera qendrore. Dëshiron të di se me çfarë procedurash do ti jepni në shfrytëzim këto objekte për vitin e ardhshëm.
**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-** kërkoj të di se përse në plan nuk është paraparë  objekti i ish-shkollës "Migjeni" në Stanoc të Epërm që ishte paraparë të shndërrohet në  çerdhe, nuk është ky plan, kurse i njëjti projekt është paraparë në buxhet, dhe kësisoj këtu kemi një kontradiktë andaj kërkoj që kjo çështje të sqarohet.
**Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-**pasi i përshëndeti të pranishmit vlerësoi se sa i përket planit të punës së kryetarit, është plani i cili është hartuar në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë komunale dhe ky plan sigurisht që ka nevojë për plotësime dhe ndryshime për atë edhe diskutohet në Kuvendin, sepse i njëjti ka disa lëshime teknike. Pastaj sa i përket shkollës fillore në Stanoc të Epërm "Migjeni", ky projekt është në plan të buxhetit i aprovuar në buxhet të komunës. Gjithashtu

do të jetë edhe në plan të prokurimi dhe sigurisht që fillimi i procedurave do të shohë në bazë të planit të prokurimit publik dhe po shpresojmë që në shtator të vitit të ardhshëm të filloj mësimi në atë pjesë, dhe në institucioni parashkollor. Sa i përket pjesës së inicimit të procedurave, për objektet kulturore nuk e kam pa mirëpo veç duhet qartësuar që ato objekte nuk janë në kompetencë të komunës dhe sigurisht që nuk do të jepen në shfrytëzim.
**Lorik Maxhuni, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë -** vlerësoj jashtëzakonisht shumë që keni ndalë edhe ke analizuar plane e punës së Drejtorisë Shëndetësisë, për çfarë ju përgëzoj fillimisht. Tek çështja e shtëpisë është situatë e cila udhëhiqet nga Shkëndije Pllana, realisht tek fjalia që ju cituat për aktivitetet për personat rezidentë, është e vërtetë që persona të cilët qëndrojnë aty kanë nevojën për të dalë në ambiente të jashtme, për të vizituar vende të ndryshme për të dalë në natyrë për të bërë aktivitete. Ne e kemi edhe anëtaren e kuvendit Nurie Halili, e cila është pjesë e stafit punëtor aty, dhe se po bëjnë një punë të mrekullueshme çdo ditë që t'u ofrojnë shërbime dhe trajtime e duhura atyre personave. Sa i përket çështjes së automjetit, ata e kanë një komb, i cili është jashtë funksionit, në të cilin po bëjmë përpjekje për me rikthyer në punë, por që është një automjet tejet i vjetër. Ne kemi marrë disa furnizime të reja me automjete në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë edhe do të mundohemi që vitin e ardhshëm, të paktën t'u japim një automjete në shfrytëzim për nevojat e shëndetësisë individuale që të paktën dhjetëra persona të kenë mundësi që të realizohen aktivitetet e tyre jashtë qendrës ku ata realisht banojnë. Ata kanë pasur në vitin 2023 disa procedura të dështuara për blerjen e atyre mjeteve, për shkak të shumës së mjeteve financiare që kanë pas dhe ne kemi me u munduar që në vitin 2024 të paktën ta realizojmë edhe këtë kërkesë të tyre, që në mënyrë sa më të shpejtë ta kemi automjetin për këtë qendër.

**5.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për lirimin nga taksa për shfrytëzimin e hapësirës publike në hollin hyrës (korridorin qendror) të Komunës për më pak se një vit;

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-** me sa e di për shfrytëzim të hapësirave komunale deri në periudhën njëvjeçare mundet me vendosë Drejtoria e Urbanizmit me një komision të brendshëm dhe një material i tillë nuk e di pse duhet me proceduar në Kuvend kur ligje e parasheh që duhet me u vendos në Urbanizëm deri në një vjet, ndërsa për kontrata mbi njëvjeçare, atëherë po mund të sillem në Kuvend, nëse po një sqarim.
**Fortuna Krasniqi, drejtoreshë e DUMM-së-** sqaroi se e kemi pru këtu për me vendosë jo për dhënie në shfrytëzim por për me liruar prej taksës.
**Agron-Përçuku, anëtar i kuvendit-** këtë çështje e kemi diskutuar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe është mbete si diskutabile, për arsye se komuna nuk ka akoma kontratë me Post-Telekomin e Kosovës. Nuk e di qysh mundesh me liruar nga taksa kur nuk ke kontratë, është mirë që fillimisht me bo kontratën, më pas me liruar prej pagesës, edhe është një çështje tjetër që nëse posa Telekomi i Kosovës paguhen nga taksat e komunës nga qytetarët nuk e di pse kemi nevojë me liruar nga taksa për çfarë arsye.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-** pyeti se a ka bërë kërkesë posta për lirim nga kjo taksë apo po veprojmë pa pasur fare kërkesë ? A e ka posta gjendjen e rendura ekonomike, sa duhet me ia heqë, këto 500 euro, apo po doni vetë me liruar prej kësaj ngarkese të tatimit. Unë e kam thënë që edhe në KPF, po e them edhe këtu publikisht, e mbështetësim edhe institucione publike më u zhvillu ekonomikisht në këtë rast edhe postën, megjithatë, për mendimin e tij, është shumë e padrejtë që një qytetar që shet gjëra festive për vitin e ri atij i akordojmë taksë, ndërsa një biznes që gjeneron qarkullim milionësh i heqim taksën. Kjo nuk është një logjikë e mirë e funksionimi dhe është pabarazi e hapur, është mirë të analizohet mirë kjo çështje para se të vendoset.

**Fatmire Cecilia, anëtare e kuvendit-** lexoj arsyetimin e Drejtorisë së Urbanizmit bazuar në kërkesën e parashtruar nga Posta e Kosovës me numër protokolli të datës 13.11. 2023, me të cilën ka kërkuar që të lejohet shfrytëzimi i hapësirës publike brenda Komunës së Vushtrrisë për ofrimin e shërbimeve postare më afër qytetarëve të komunës së Vushtrrisë. Drejtoria, pas parimit të kërkesës, ka mbajtur një takim në Komisionin për Shqyrtimin e Kërkesave për më pak se një vit. Pas rekomandimit nga komisioni, në të cilën ata rekomandojnë dhënien në shfrytëzim të kësaj hapësire për më pak se një vit Ndërmarrjes Publike Posta e Kosovës, me arsyetimin se është lehtësimi në interes për përmbushje sa më të lehtë të kërkesave për shërbimet postare të qytetarëve të kësaj komune. E lexova për arsye se posa nuk ka kërkuar lirim nga taksa , sepse kërkesa cekë që këtu po kërkohet vetëm dhënia në shfrytëzimi e hapësirës banda për banda objektit të komunës, ndërsa jo lirimi nga taksa komunale.
**Fortuna Krasniqi, drejtoreshë e DUMM-së-** dha sqarimet e nevojshme në çështjet e ngritura nga anëtarë e kuvendit.
**Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-** sqaroi se posta e Kosovës nuk është që po vendoset tash, ka qenë e vendosur edhe më herët para se të vijnë në pushtet kanë qenë e vendosur në objektin e komunës edhe qëllimi ka qenë ofrimi sa më i lehtë i shërbimeve për qytetarët dhe mendon që edhe në njëfarë forme ju krijojmë lehtësira qytetareve, mirëpo e dimë që posa nuk është gjendje të mirë dhe ka nevojë për mbështetje prej institucioneve tjera në këtë rast nga komuna. Kërkesa ka ardhur prej një institucioni qendror, që edhe Ligji për Dhënien në Shfrytëzim i jep të drejtën që kur ka kërkesa prej institucionit qendror, me pas dallime tek vendimet e Kuvendit. Qëllimi i kësaj kërkese ka qenë ofrimi i lehtësimeve për ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetaret, por nëse ka nevojë për një analizë më të mirëfilltë kjo pikë e rendit të ditës mund të shtyhet për një mbledhje tjetër. Problemi është që në Rregullore për dhënë në shfrytëzim nuk është e cekë lirimin nga taksa dhe kjo duhet të rregullohet.
**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-** kërkesa ime ishte që s'ka pas kontratë, fakt që nuk ka kontratë, meqenëse është kontrata për afat njëvjeçar është mirë që në atë kontratë, të caktohet një nenë kur lirohet nga pagesa. Ndryshe është antiligjor nëse vjen një propozim-vendim për lirim nga taksa, kur nuk kemi fare kontratë me atë kompani sepse ka përjashtim të konkurrencës. Kështu që ky vendim që ka ardhur në Kuvend për lirim nga taksa është i pa kuptimtë.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me 25 vota "për" 3 vota "kundër" të tjerat "abstenim" vendosi që kjo pikë të shtyhet për ndonjërën nga mbledhje e ardhshme të kuvendit.**

**6.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënien në shfrytëzim për vitin 2024;

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit-** sqaroi para anëtarëve të Kuvendit, që këtë pjesën e listës e keni në adresat elektronike ndërsa në kopje fizike nuk e kemi për shkak se është shumë voluminoze.
**Remzi Ahmeti, drejtor i DGJKP-së-** sqaroi se duke i marr për bazë rekomandimet e komisionit, që është formuar, ne i kemi merr i kemi kontroll të gjitha pronat një nga një dhe besoj që për herë të parë i keni të vendosura të gjitha pronat, të cilat janë për shfrytëzim në listën e veçantë. Lista e cila ka ardhur në adresë-elektronike në ndërkohë përfshihen të gjitha pronat komunale, kjo vlen për shkak të transparencës, ku janë përshirë të gjitha zonat kadastrale atje ku komuna mëton të jap në shfrytëzim pronën komunale.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-** vlerësoi se me të vërtetë, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka volum shumë të madh të punëve dhe në të vërtetë sfidat janë të mëdha, sidomos tek dhënia në shfrytëzim dhe tek menaxhimi i kontratave ka shumë probleme me pagesa, me mirëmbajtje e të gjitha këto, drejtori e dha një sqarim nuk e di a e kuptova mirë! Drejtor propozim-vendimin, të cilin e kemi në letër, janë disa prona këtu, domethënë ne votojmë për këto prona, të cilat i kemi fizikisht këtu. sepse kemi pranuar mbrëmje një email me të gjitha pronat komunale. Unë mendoj që s'kemi nevojë si kuvend i komunës t'i fusim të gjitha pronat komunale në listën për dhënie në shfrytëzim, sepse paraprakisht drejtoria duhet me bë një analizë mbi ato prona. Fatkeqësisht, ka prona të cilat janë të uzurpuara ka prona të cilat janë të pa qasshme, ka prona të cilat nuk mund të jepen në shfrytëzim për arsye të ndryshme dhe nëse e kuptova drejt, atëherë jemi në rregull. Në propozim futen vetëm këto që janë të cilat janë sjell fizikisht këtu, nëse e kuptova drejt.
**Remzi Ahmeti, drejtor i DGJKP-së-** sqaroi se në kuptimin që mos të kemi kufizim dhe cungim në shprehjen e interesit qytetar për këto prona e të cilët janë në një volum të madh i kemi propozuar të gjitha për dhënie në shfrytëzim, në adresë-elektronike janë dërguar të gjitha prona sepse për shkak të volumit nuk kemi mundur ti procedojmë në kopje fizike. Kërkoj të aprovohet ky vendim me të gjitha pronat e procedura në kuvend.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-** respekt për punën që po e bënë edhe vetëm nxjerrja e kësaj liste, donë punë, veç nxjerrja e saj me gjithë pronat donë punë, se jo me u merr me secilin veç e veç. Atë e kemi parasysh dhe duhet ti themi gjërat qysh janë. Mirëpo, Ligji për Dhënien në Shfrytëzim nuk thotë që duhet të futen në listën për dhënie në shfrytëzim të gjitha pronat komunale. Lista e përgjithshme nuk thotë askund ligji që duhet me kanë krejt pronat komunale. Lista e përgjithshme është ato të cilat komuna i sheh me interes edhe të cilat mundet me i dhanë në shfrytëzim. Ne duhet ta kemi parasysh prapë po e ripërsëris që shumë prej këtyre provave, fatkeqësisht kjo nuk ndodh veç në Vushtrri, po edhe në gjitha qytetet tjera nuk kanë qasje në infrastrukturë, janë të uzurpuara dhe paraprakisht Drejtoria Sektori i pronës duhet t'i trajtojë këto çështje dhe t'i sjellë pronat e lira, të cilat në të vërtetë munden me u dhënë shfrytëzim. Unë mendoj që Komuna është dashtë me bë punë pak më të detajume dhe m'i sjellë pronat, të cilat me të vërtet janë në interes për dhënien në shfrytëzim dhe jo në këtë mënyrë me një shabllon të futen, sepse në atë listë, të cilën na është dërguar në email, janë përfshirë edhe pronat, sepse janë infrastrukturë, janë përfshirë edhe rrugët, janë përfshirë edhe pjesë tjera të cilat realisht nuk mund të jepen në shfrytëzim. Pra duhet të kemi kujdes se çka po fusim në atë listë.
**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-** tha se tek vendimi për publikimin e listave së pronave, të Komunës së Vushtrrisë për dhënie në shfrytëzim për vitin 2024 figuron edhe lokali afarist i cili gjendet në parcelën kadastale njëqind e 127-0 ZK Vushtrri. Në rrugën Dëshmorë të Kombit, me sipërfaqe prej 90 m$^2$. Dua të them se kur e lidhim këtë tek raporti i Komisionit për Verifikimin e Pronave, tek tokat bujqësore dhe objektet afariste figuron një kontratë e lidhne për këtë lokal afarist është me kohë të caktuar deri në shkurt dhe kërkoj që kjo ky lokal afarist të hiqet nga kjo pjesë, meqenëse ka lidhje të kontratës, pavarësisht që kjo kontratë ky qiramarrësi, i cili e ka emrin Fatmir Ferizi e ka një borxh ndaj komunës diku 29,000.00 euro borxh Nëse ky nuk është tërhiqë prej qiramarrjes, atëherë kërkoj që kjo ky lokal të hiqet nga lista kjo parcelë të hiqet nga lista për jepje në shfrytëzim nëse nuk ka ndonjë dorëheqje prej pronarit.
**Remzi Ahmeti, drejtor i DGJKP-së-** thasë këtë çështje, e kanë diskutuar bashkë me Komisionin dhe saktë, dihet se kontrata ka përfunduar dhe i janë dërguar shkresat për shkëputje të kontratës.,
**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-** kjo është ashtu, ky qiramarrësi nuk ka bërë pagesë gati dy vite Është mirë me iu shkëputë kontratën këtij qiramarrësi. Këtë edhe kur e ka pas qiranë e këtij

objekti. Këtij lokal afarist e ka keqpërdorë kontratën e komunës, e dimë fort mirë, e ka jep nën kontraktim, që s'ka të drejtë me jep nën kontraktim. Kështu që është mirë si Drejtori me ia shkëputë kontratën këtë dhe të gjitha atyre të cilët e kanë keqpërdorë kontratat që kanë vënë në nën kontraktim, që nuk kanë të drejtë ligjore edhe po përfitojnë tash e tre-katër vite po përfitojnë nga qiraja, të cilat ju ka skaduar kontrata. Është mirë me identifiku shumë mirë persona, të cilat i kanë marrë kontratat, i kanë marrë qiratë dhe i kanë nënkontraktu, kështu që është mirë tek sektori i pronës ta funksionalizoni sa më shpejt dhe të mos e lejonit keqpërdorimin e pronës publike.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me 31 vota "për" 1 votë "kundër" vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim aprovohet propozimi i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë për publikimin e Listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënien në shfrytëzim për vitin 2024.

**2.** Pronat e përshkruara në listë mund të jepen në shfrytëzim vetëm pas plotësimit të kushteve ligjore dhe planifikimit në bazë të Planit Zhvillimor Komunal dhe dokumenteve të tjera të planifikimit.

**3.** Me qëllim të nxitjes të zhvillimit ekonomik, rritjen e vlerës së pronës si dhe shtimin e vendeve të punës në harmoni me planifikimet e komunës, Komuna e Vushtrrisë në të ardhmen planifikon të jep në shfrytëzim pronën e komunës dhe në varësi nga interesi publik të zhvillon procedurat për dhënien në shfrytëzim të pronës së komunës.

**4.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista e pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënien në shfrytëzim për vitin 2024.

**5.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

**6.** Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen Zyrtare të komunës së Vushtrrisë.

**7.** Shqyrtimi i Informatës për shërbimet sociale dhe të asistencës në Komunën e Vushtrrisë;

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-** pyeti sa ka diçka të planifikuar lidhur me strehimin ose ndërtimin e shtëpive për personat e pastrehë ose personat që kanë përjetuar fatkeqësi natyrore të ndryshme dhe e kanë humbë banimin e vet, në mandatin e kaluar dhe jo për ta ngritë kështu kuptimin e punës, ashtu që nga 23 familje i kemi bërë zgjidhje. I kemi dhënë një buxhet duke ndërtua shtëpitë ashtu që përmes komisionit të Kuvendit janë bërë zgjedhë krejt ato rastet më të rënda. Nuk kemi parë ndonjë rast konkret diçka në këtë aspekt të dy vitit e para dhe nuk e di a keni planifikuar diçka nga fondi për bashkëpunim qoftë edhe me këto mjete që i keni për bashkëfinancim me zgjidhë çështjen e banimit për familjet të pastrehë të komunës tonë.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-** njoftoj se komuna ka nënshkruar marrëveshjen me islamikun reliefin, domethënë që bashkëfinancimi për ndërtimin e shtëpive është marrëveshje dyvjeçare dhe tash të dhe tani për 20 shtëpi do të iu dorëzojmë çelësat për ato shtëpi, me ju thonë të drejtën sipas

marrëveshjes. Tutje shtoj se do të ishte mirë të mendohet ndërtimi i ndonjë objekti kolektiv, me të cilin do të bëhet zgjidhje afatgjate për familjet që janë të pastreha.

**8.** Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit të Komisionit lidhur me shfrytëzimin e pronës komunale ZK-Gracë;

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-** sa i përket kësaj pike, vota e tij do të shkon për. Dash Zoti që mos përsëritet rasti i Lumit të Madh, se sot e dy vjet kaluan edhe kurrë nuk u morë asnjë vendim edhe pse ka pas bazë ligjore, edhe prej na plus na ka ardhë vendimi edhe na si Kuvend e kemi aprovuar e për hapjen e 900 vendeve të punës. Kështu na është thanë Unë, si asambleist, çdo herë që shkon në interes, çdo projekt që vjen në interes të qytetarëve do ta votojë dhe do ta shtyjë atë votim përpara. Tash e kemi pak më lehtë te rasti këtu, se te rasti çka mujta me e pa dhe me lexue te dy operatorët ekonomik kanë vendosur të tërhiqen edhe rastit që ke tjetri që të dytë kanë dhënë mendimi për të tërheqje Unë prapë po kthena tek Lumim Madh, se këtu besoj që do u nënshkruajmë kryetar qysh kanë bo gabime ata në mandatin e kalume, që pata thanë e kanë votue jashtëligjshëm, në të njëjtin gabim jetë u ba edhe ti që nuk pe kryen këtë punë nuk po procedon. Ndoshtë e pranojmë, ndoshtë mos e pranojmë, për mua jemi zero-zero, barabartë Edhe qeverisja e kaluar e lënë në këtë pikë edhe kjo qeverisej.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-** sa i përket këtyre dy raporteve, sepse unë e tjetër raport nuk kam parë nga i njëjti komision. Me të vërtetë, punën të cilën e ka bërë ky komisioni është voluminoze dhe është një punë e mirë, por fatkeqësisht kryetar kemi thënë së formimi i këtij komisionit është një komision i kundërligjshëm kryetar nuk mundet me funksionuar komisioni paralel me drejtorin, sepse kompetenca janë të ndara dhe nuk i takojnë komisionit. Kontratat janë të qarta kryetarë. Nëse operatorët të cilët kanë marrë prona me shfrytëzim, nuk i përmbahen kontratës, edhe me rastin e Parcelës në Gracë atëherë nuk ka nevojë komuna me formuar komision sepse janë përgjegjësi të caktuar ligjore të kryetarit dhe të drejtorit të Gjodezi Kadastër dhe Pronë, se tash janë punë të panevojshme që kanë bërë këta anëtarët e komisionit, , sepse ligji e parasheh që nuk i përmbahet kontratës, ju shkëputet kontrata. S'ke nevoja as me konstatuar kurrgjë as me vetëm le të zbatohet ligji. E njëjta me raportin tjetër i kemi me shifra detaje sa është paguar për prona bujqësore, sa s'është paguar, çka është bërë, dhe çka nuk është bërë. Këto janë përgjegjësi të Drejtorisë së Gjeodezisë, Katastrit dhe Pronës është sektor i veçantë, i cili duhet me u merr me mirëmbajtjen e kontratave për dhënie shfrytëzim. Nuk ka nevoja tash nëse dikujt i bie, domethanë haxhi edhe një komision tjetër me me me kontrollu punën e këij komisioni. Nuk kam asgjë kundër kësaj pune, kryetar, po është në kundërshtim me dispozitat ligjore. edhe si të tillë ne nuk na nuk do ta votojmë jo për arsye se jemi kundër opinionit të komisionit Po jemi kundër procedurës së formimit të një Komisioni të tillë kundërligjor. Edhe tani thotë Komisioni, verifikon pronë prej vitit 1999 deri në 2022, a ka ndonjë kriter se çka e realizojnë këta, a qa çka t'ju bie ndër mend. sepse bashkë kryetari i këtij komisionit ka pas ndër vite problem me pronë komunale, pse s'pe merret me këqyrë pak atë pronë komunale, me na pru një raport atë pronë komunale, për cilat arsye kryetarë me bindje ju them që ky komision është në kundërshtim me ligjin.
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-** vlerësoi se është për t'u çuditur diskutimi i përfaqësuesit të Lidhjes Demokratike të Kosovës për punën e komisionit kur dihet që në këtë komision, me vendim të Kuvendit, kemi qenë pesë anëtarë të komisionit dhe nga pesë anëtarë të komisionit, dy kanë qenë nga LDK-ja. Pra, si opozitë keni qenë të përfaqësuar jashtëzakonisht shumë në këtë komision edhe pse në bazë të informatave që i kemi edhe nga takimet që kemi pasur, njëri nga anëtarët e komisionit nuk ka marrë pjesë ose ka dhënë dorëheqje, është çështje e tij. Si komision i dimë

përgjegjësitë dhe kompetencat tona dhe kemi bërë një punë jashtëzakonisht të mirë dhe voluminoze, për çfarë falënderoj të gjithë anëtarët e komisionit që kanë marrë pjesë në këto takime dhe dua të theksoj që edhe kur e kemi dhënë në shfrytëzim pronën në Gracë, për ndërtimin e fabrikës së peshkut, në mandatin e kaluar, në vitin 2019, me thanë drejtën kemi qenë skeptikë, disa prej neve kemi qenë shumë skeptikë, por në veçanti ka qenë z.Ali Januzi asamblisti ynë, që ka thanë po më duket diçka goxha si e paarritshme, që peshku në Kroaci e fabrika në Gracë, nuk do të mund të realizohet ky projekt. Si komision i kemi hulumtuar të gjitha detajet e kontratës, po ashtu kemi ftuar përfaqësish-kryetarin e komunës në takim, i cili nuk ka marrë pjesë, kemi ftuar përfaqësuesit e Emona Grupit të cilët na u kanë përgjigj ftesës, është edhe procesverbali, përfaqësues nga Emona Grup, drejtori e i përgjithshëm Latif Resyli edhe Driton Krasniqi, me të cilët kemi pas një takim të frytshëm disa orësh dhe me të cilët pastaj në fund të takimit na i kanë sqaruar arsyet sipas tyre pse nuk ka ardhur deri te ndërtimi i fabrikës, sipas tyre ka qenë shfaqja e pandemisë Covid, pastaj lufta në Ukrainë, shtrenjtimi i materialit ndërtimor dhe shumë probleme tjera ka telashe edhe në kontratë. Kontrata nuk është si duhet, megjithatë, në fund të takimit ata kanë paraqitë para neve si anëtarë të komisionit kërkesën që kjo pronë, pra të bëhet shkëputja e kësaj kontrate me mirëbesim dhe të mos kemi padi as nga komuna në drejtim të kompanisë, po as nga ana e kompanisë në drejtim të komunës. Për çka ju jemi mirënjohës, po ashtu si komision kemi thënë që kjo çështje nuk është kompetencë jona, e kemi pruar në Kuvend si raport, pastaj janë rekomandimet me të cilat besoj që në një të ardhme të afërt do të merret kuvendi i komunës dhe kjo pronë është publike, janë më tepër se pesë hektarë, me vendim të Kuvendit, pra duhet t'i kthehet Komunës së Vushtrrisë. Është interes qytetar që pronën mos ta lamë djerrinë kjo pronë, derisa i është dhënë në shfrytëzim asaj kompanie me vendim të Kuvendit, ka qenë e shfrytëzueshme prej qytetarëve ka qenë pra interes edhe qytetar, por edhe interes i komunës. Prandaj, si hetim kërkojmë nga kryetari i komunës që ta respektojë rekomandimin që e kemi dhënë ne si komision.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit-** pasi i përshëndeti të pranishmit shtoj se vërtet në njëfarë forme, e tha edhe kolegu Haradinaj: Kur ka qenë çështja e kësaj parcele, vërtet unë e kam ngritë zërin dhe nuk kam marrë pjesë në votimin. Arsyeja pse nuk marr pjesë është sepse duhet të kesh vizion! Unë atë ditë jam dalë dhe kam qëndruar, në kafe duke pirë çaj dhe nuk jam ardhur me votuar. Sepse vërtet më ka marr mendja e ashtu doli dhe bëri mirë po themi në një farë forme që z.Haradinaj më gradoj se shumë herë, partia ime, sikur të më dëgjonte shumë herë e do ti kishte punët mirë. Unë e sot jam pishman kur ka qenë ajo parcela që është ndërtuar po ajo qendra tregtare qysh po quhet, , atje në pronën e kooperativës bujqësore që ishte që votuam atëherë, fakt që ka qenë propozimi me u bo një zonë për gjelbërim dhe tash ajo është një qendër tregtare qysh po e quajt atë. Dhe unë sot jam pishman pse kam votuar, sepse ma mirë ka qenë me qenë zonën e gjelbër se sa me u shit atje do karamele e do keksi! Prandaj, po e them kryesisht edhe partisë time, nganjëherë merrni atë vizionin tim, po dëgjoni ngaherë se ma mjerë u bie. Edhe një herë po them, propozimi i asaj parcele e kam ditë 100% që s'del asgjë prej asaj pune.

**Bekim Zabergja, anëtar i kuvendit-** tha se sa i përket raportit të Gracës kisha dëshiruar të kemi vëmendjen të dëgjojmë Shkojmë me rend me raport, mos të kemi ngatërrim që raporteve që janë shqyrtim në këtë seancë. Jemi duke shqyrtuar vetëm raportin që është në rend të ditës. Raportin e kemi bërë me kohë, materialin e keni lexuar, dhe të njëjtin e keni pranuar me kohë. Ajo çfarë dua të iu them jashtë raportit dhe me arsyetuar pse nuk u paraqit në raport, sepse dyshimet komisioni nuk i paraqet në raport. Mirëpo, nëse mund nga aspekti ekonomik, nga aspekti profesional Dua t'ju them të nderuar kolegë deputetë, anëtarë të Kuvendit aty qëllimi nuk ka qenë për ndërtimin e fabrikës dhe ketë e themi sepse as në aspektin teorik nuk ka pasur shans ndërtimi i asaj fabrike të peshkut, në një shtet ku bregdeti është në një shtet tjetër, por janë dhënë në shfrytëzim 5 hektar

tokë për të mashtruar. Përse është dhënë prona e komunës pesë hektarë vetëm ka qenë mashtrim i opinionit publik! D.m.th. mashtrim ka qenë, dhe ja arsyeja pse po themi sepse shans teorike s'ke t'i nisësh me importuar lëndën e parë prej detit me pru 800 kilometra në Kosovë asnjë formë së mundesh hiç sepse nëse bartet me frigorifer ndodh Shkrihet, ngrihet, nuk funksionon kjo formë, s'ka shans. Pra pika kryesore ka qenë me i mashtruar qytetarët për me fituar votën, plus ato e ka e ka cekë edhe shtresën e margjinalizuar numri më i madh i papunësisë në Kosovë, shtresën e mesme të grave, që edhe gratë do ti punësojmë, kjo ka qenë mashtrim. Mirëpo me një fjalë mashtrimit ju kanë bashkëngjita edhe ato dy kompanitë dhe garantoj në emër të tij dhe në emër të kryesuesit të komisionit se do të ushtoj kallëzim penal kundër ish kryetarit të Komunës, dhe ndaj këtyre bizneseve.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-** vlerësoi se kur bënë me kositë bari, dimrit bënë me pru peshk me kontejner., dhe shtoj se fatkeqësisht një qasje e tillë, unë nuk pata kurrgjë kundër komisionit dhe përbërjes së komisionit, por mënyra e formimit të komisionit, po besoj që kryetari e kuptoi, është e gabueshme. Jeni jashtë kompetencës të juaj për me trajtuar këto çështje. Sa i përket investitorit të atëhershëm, një grup i atëhershëm nga komuna ka qenë e ka vizituar fabrikën në Kroaci. Investimi ka qenë shumë serioz por, e dimë të gjithë se pandemia i ka ndalë bizneset edhe më të forta, e jo këtë lloj biznesi që ka pas me u zhvillu atëherë. Pavarësisht asaj, ideja është që komisioni është t'u kapërcye kompetencat e veta duke hy në kompetencat e kryetarëve të komunës dhe në kompetencat e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë punën të cilën e ka paraqitë është një punë e shkëlqyeshme, duhet me shkëput kontratën, nuk ka diskutim aty, mirëpo jo në këtë formë, jo nga ky komision dhe për këtë arsye në këto dokumente që i sjell ky komision, nuk i njohim, sepse është i kundërligjshëm.
**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-** tha se pa dashur të polemizoj dëshiron të sqaroj se këta se çka po mundohen me proklamuar nuk është e qëndrueshme për faktin se komisioni është i themeluar nga ky kuvend është bile-bile edhe kolegu Adnani ka propozuar anëtarë për të qenë në atë komision. Po pse ka munguar apo pse është tërhequr në vazhdimësi, janë ndoshta pikërisht keqpërdorimet që janë bërë edhe kështu që komisioni është i ligjshëm, e ka obligim m'i krye detyrat deri në fund të mandatit, ashtu siç e ka miratuar ligjshmërinë e këtij komisioni me MAPL-ja, kështu na si komision e kemi ndërmend me punuar, pavarësisht që në komision që është premtuar se komisioni ka me pas edhe pagesa, nuk janë paguar ato pagesat, pra do të punojmë edhe në mënyrë vullnetare nëse është e nevojshme por do të mundohem me kryer detyrën me përgjegjësi, ashtu qysh e kemi marrë nga ky Kuvend si anëtarë të Komisionit.
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-** tha se dua të sqaroj Adnanit që komisioni nuk ka bërë shkëputje të kontratës sepse po e dezinformon opinionin, ne e kemi shqyrtuar si lëndë dhe në fund jemi ardhur me rekomandime, por po shihet se nuk e ke lexuar materialen Po ta lexoj rekomandimin nga komisioni: autorizohet kryetari i komunës, në cilësinë e qiradhënësit , që të bëj shkëputjen e kontratës me mirëbesim të lidhur në vitin 2020 mes komunës Vushtrrisë dhe kompanisë me unë grup SHPD, me partneritet, kompaninë Kroate Konex Trade Duo, në cilësi qiramarrësit pas shkëputjes së kontratës me mirë mirëbesim nga të dy palët, të shfuqizohet vendimi i Kuvendit Komunal Vushtrrisë numër 294/19 i datës 31 dhjetor 2019 për dhënë shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës varësisht parcela, në zonën kadastrale Gracë.Pra, Komisioni nuk ka shkëputjen e kontratës, por e ka shtjelluar në detaje lëndën edhe i ka dhënë rekomandimet për kryetarin e komunës edhe për kuvendin komunal.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës**-tha se nëse më lejoni shumë shkurt, se u përmend çështja e komisionit, u përmenden shumë çështje të tjera, po krejt kjo ka ndodhë me qëllimin ma të mirë, me pas një transparencë për të mos lënë dilema që kryetari i komunës e formoi një përgjegjësitë të

caktuara nga kuvendi. Tutje shtoj se po t'i ishin zgjidh këto probleme, po më duket e ke udhëheq drejtorin e Kadastrit, këtu nuk kishin me ardhur në kuvend hiç, kishin me qenë çështje të kryera, domethënë komuna e kishte ditë sa kur ka pronën kush po e shfrytëzon pronën dhe tash për me kuptuar drejt dhe saktë është nevojitur kjo pune. Por e përmende ligjin shumë dhe tash për me bë edhe më transparente edhe me vetë faktin që u dhanë në shfrytëzim objekti i vjetër i shkollës - Migjenin në Stanovës. në kundërshtim me ligjin pa fletë poseduese dhe pa i respektuar kriteret. Do me thanë, do me thanë është dhënë në mënyrë të jashtëligjshme dhe i ka ardhur shumë keq për operatori, sepse i njëjti ka investuar shumë dhe kemi ardhur në atë pikë, për mos me vazhduar kontratën, tash ia kam dhënë kompanisë detyrat projektuese edhe brenda pak ditëve e bënë projektin detaj për me shndërrua në çerdhe, bashkë me oborrin aty me kopsht edhe gjithçka. Ky është një prej shkeljeve. Shkelje të tjera, që janë në rend që i kemi përmend, kur është në pyetje pronat, janë ndërtimi i objekteve, domethënë që janë pronat të AKP-së. po nuk po i përmendi, se e kemi përmendur herëve të kaluara. Unë nuk e kam telashe ato, por telashe që më pronë të huaj e keni ndërtuar objektin. Sfida tjetër është se keni nënshkruar kontratën me ketë bashkë financuesin, kontrata është e nënshkrume, për objektin e shtëpisë së pëlqeve dhe tash nuk mund të bëhet asgjë sepse projekti është në përfundim. Në fund falënderoj anëtaret e komisionit për punën që kanë bërë.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me 21 vota "për" të tjerat "abstenim" aprovoj raportin e Komisionit lidhur me shfrytëzimin e pronës komunale ZK-Gracë.**

**9.** Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit të Komisionit lidhur me shfrytëzimin e pronës komunale-tokat bujqësore në Komunën e Vushtrrisë;

**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-** tha se sa i përket raportit për dhënin e pronave bujqësore në shfrytëzim, siç e potencova edhe më parë, nuk dua të zgjatem për shkak se materialin e keni marrë me kohë dhe unë prita që sot në këto raporte anëtarët e Kuvendit të përqendrohen vetëm në përmbajtje të raportit Mirëpo, më duhet m'i dhënë disa përgjigje z.Adnan Lahu, se i shpreh disa pyetje dhe vërejtje. E para komisioni i cili është mandatuar nga Kuvend, e ka legjitimitetin e plotë me verifikuar çdo proces të dhënies në shfrytëzim qoftë dhe për kontratat, qoftë dhe për pagesat, në gjithë aspektet Ndërsa, sa i përket këtij raporti, këtë punë u dashtë me krye sektorit i pronës. Është e vërtetë që sektori i pronës nuk është funksional dhe u dashtë fillimisht dhe nëse dikush është dashur ta lavdëron këtë komision, i ka ra Adnan Lahu, për shkak se ka qenë drejtor i Kadastrit, dhe unë prita që fillimisht vetë kërkoj falje, që gjatë mandatit të tij nuk e ka kryer as edhe një punë sa i përket çështjes së shfrytëzimet e pronave komunale, e mos flasim për uzurpimet tjera. E kisha kuptuar shumë mirë, nëse kish filluar diçka me bë, dhe në mungesë stafit mos arrit me kryer një punë tjetër. Mirëpo komisioni edhe këtë vakum e ka plotësuar dhe e ka kryer punën e sektorit të pronës, kështu që asgjë s'u mbet keq për këtë mandat. Mirëpo, çfarë dua të them është se për njoftimin të gjitha kontratave, menaxheri i zbatimit të kontratave nga kuadër të Drejtorisë për Pronë ka vepruan dhe e ka njoftuar zyrtarisht ish-drejtorin, Adnan Lahu , dhe ish-kryetarin e komunës që kontratat që kon të bëjnë me këto prona janë skaduar, por nuk është ndërmarr as edhe një veprim tjetër në këtë drejtim, sepse keni qenë të përqendruar në tjera zona, zonë ekonomike, pastaj me ndërru ngjyrat e zeza në vetura e kështu me radhë. U përmend këtu dhe tha: pse kryesuesi i Komisionit nuk e ka paraqitë në raport për shfrytëzimin e një prone, të cilën e ka shfrytëzuar? E pra, pyetja është jo e drejtë, sepse s'ke njohuri as bazike. Në shfrytëzimin Firma ime ka dhe të

pronës komunale siç është Bufeja, në shkollën “Lutfi Musiqi”, e ka shfrytëzuar prej datës 05 marsit 2005 deri më 05 mars 2008 dhe po me këtë datë pushteti i partisë tuaj e ka ndërprerë kontratën dhe nuk e ka vazhduar dhe përpos kësaj i ka bërë dëm të madh biznesit tim, duke ia vu drynin, me pretekste gjoja se Firma im s'ka paguar qiranë. Në këtë drejtim pushteti nuk ka lënë, formë më primitive, pa e përdorë, për të ia mbyllë lokalin. Keni pagur njerëz për të dhënë deklarata se janë helmuar në bufe, keni leshu ujët, e keni ndalë ujët e forma tjera primitive. Prandaj ceku se nuk mund të ofrosh raporti për një pronë e cila i është kthyer komunës. Dhe nuk është e rëndësishme se ajo pronë a është kthyer në formë të ligjshme a të kundërligjshme ajo është duke u shfrytëzuar prej 2008 për laboratorët në shkollën e mesme.
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**tha se raportin të cilin e kemi përgatitë si komision ka gjetur disa të dhëna të cilat janë shumë interesante. Derisa qiramarrësit qytetarët e Vushtrrisë kanë bërë kërkesë për marrjen në shfrytëzim të pronës komunale, qoftë objekteve, qoftë tokës bujqësore por pas ndryshimit të kontratës, një numër i madh i tyre nuk i kanë përmbajt kontratës. Pra, nga raporti shihet se i kemi disa kontrata, të cilët Komunës së Vushtrrisë i kanë një shumë goxha të madhe borxh për shkak të mos përmbushjes së obligimeve, siç e kanë në kontratë, respektivisht obligimeve mujore dhe duke marrë për bazë gjendjen faktike, komisioni ka konstatuar që vlera e përgjithshme e obligimeve të shfrytëzuesve të pronave bujqësore lokaleve afariste ndaj komunës dhe Vushtrrisë është në vlerën financiare 127,181.060 €. Këtu kisha kërkuar nga Drejtoria përgjegjëse që është të zbatojë rekomandimet që i kemi dhënë ne si Komision dhe pronarëve, respektivisht qiramarrësve t'ju bëjë me dije që nëse vazhdohet me mos pagesë të qirasë, sigurisht që do të respektohen aktet normative dhe ligjet në fuqi. Nga ajo që shihet, nga kontratat që i kemi dhe se këto janë kontrata të vjetra, të cilat janë dhanë diku në vitin 2015 shihet që për prona, të cilat janë ose kanë pozitën gjeografike shumë të mirë për biznes, vlera e qirasë është shumë e vogël dhe kjo është shqetësuese, se si bizneset të cilat kanë marrë prona me qira nga komuna, pra kanë marrë me një vlerë jashtëzakonisht të ulët, por çfarë është edhe më karakteristike është vlerë të ulët, pastaj nuk e kanë paguar. Më erdh mirë që njëri nga rekomandimet tona që ka qenë kontrata numër ë 14-01 viti 2026 e lidhur mes komunës së Vushtrrisë dhe Vllaznim-Met-Zahitit që është e skaduar dhe kontrata lidhur mes Komunës së Vushtrrisë dhe Mehdi-Rahim-Nezirit, po ashtu e skaduar që ishte këto dy prona pra që janë skaduar, ishin në listën e pronave për dhënien në shfrytëzim dhe shpresojmë edhe besojmë dhe është obligim edhe i komunës, edhe i qeverisë komunale, edhe i drejtorëve përgjegjës që t'i marrin masat e duhura, në mënyrë që të realizohet pagesa efikase nga ana e këtyre bizneseve. .
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-** tha se papë, edhe kjo çështje që e ka sjellë komisioni këtu për diskutim është në kompetencë të kryetarit edhe të drejtorisë, këto që e kanë paraqitë komisioni është shumë e vërtetë, po nuk i kanë paraqitë edhe vitet, sepse qysh e dimë, gjithë në dy vitet pandemike Kuvendi Komunal pati marrë vendim me i liruar nga pagesa e shfrytëzuesit e pronave, është vendosur me vendim të Kuvendit Komunal. Fatkeqësisht, ky borxh është krijua gjatë dy viteve të fundit ku bizneset kanë pritë që prapë do të lirohen shumica e borxhit, kur bizneset kanë pritë që prapë komuna do t'i liron për shkak të kushteve të vështira ekonomike dhe gjendjes post pandemike, megjithatë është dashur t'u paraqitë vitet, po pavarësisht kësaj, prapë Kryetarët këtu kemi përzirje dhe ngatërrim të kompetencve.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me 24 vota “për” 3 vota “abstenim” aprovoj raportin e Komisionit lidhur me shfrytëzimin e pronës komunale-tokat bujqësore në Komunën e Vushtrrisë.**

**10.** Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit të Komisionit lidhur me shfrytëzimin e pronës komunale-lokaleve afariste-kiosqeve;

**Pas shqyrtimi të kësaj pike të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 24 vota "për" aprovoj raportin e Komisionit lidhur me lidhur me shfrytëzimin e pronës komunale- lokaleve afariste-kiosqeve.**

**11.** Shqyrtimi i raportit të Komisionit të aksionarëve të Kompanisë Regjionale "Uniteti";

**Pas shqyrtimi të kësaj pike të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 16 vota "për" 6 vota "kundër" aprovoj raportin e Komisionit të aksionarëve të Kompanisë Regjionale "Uniteti".**

**12.** Rishqyrtimin i Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale të Komunës së Vushtrrisë;

**Pas shqyrtimi të kësaj pike të rendit të ditës kuvendit pas votimit me vota "unanime" Aprovoj Rregulloren për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale të Komunës së Vushtrrisë.**

**13.** Rishqyrtimi i vendimit për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2024-2032,

**Pas shqyrtimi të kësaj pike të rendit të ditës kuvendit pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijon:**

Me këtë vendim fillohet hartimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-së) për Komunën e Vushtrrisë.

**Neni 2**
**Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor**

Me këtë vendim përkufizohet dokumenti i Planifikimit Hapësinor-Plani Zhvillimor Komunal në harmoni me ligjin si: "Plan Strategjik multi-sektorial, i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plani Zhvillimor i Komunës duhet të përfshijë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

**Neni 3**
**Qëllimi i hartimit**

Me Planin Zhvillimor Komunal, nga neni 1 i këtij Vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësit për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hap sinor të Komunës së Vushtrrisë , plotëson kërkesat ligjore për të përgatitur Planin Strategjik multi-sektorial , i cili përfshin planifikimin dhe zhvillimin e zonës urbane dhe rurale.

**Neni 4**
**Kufiri i territorit**

Zonat Kadastrale në territorin e komunës së Vushtrrisë të përfshira janë:

| Nr. | Emri i z. kadastrale | kodi i zonës | ha | ari | m² |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Balincë | 70202002 | 282 | 41 | 52 |
| 2 | Banjskë | 70202003 | 358 | 63 | 37 |
| 3 | Beçuk | 70202005 | 729 | 14 | 53 |
| 4 | Bivolak | 70202006 | 301 | 44 | 92 |
| 5 | Boshlan | 70202007 | 423 | 2 | 33 |
| 6 | Brusnik | 70202009 | 329 | 81 | 53 |
| 7 | Bukosh | 70202010 | 582 | 71 | 59 |
| 8 | Lumadh | 70202011 | 192 | 76 | 41 |
| 9 | Vesekofc | 70202013 | 895 | 37 | 45 |
| 10 | Vilancë | 70202014 | 136 | 10 | 57 |
| 11 | Vërnicë | 70202015 | 424 | 38 | 62 |
| 12 | Vushtrri | 70202016 | 1847 | 87 | 00 |
| 13 | Gllavatin | 70202017 | 262 | 15 | 21 |
| 14 | Gojbulë | 70202018 | 692 | 36 | 23 |
| 15 | Dumnicë e Epërme | 70202019 | 696 | 96 | 79 |
| 16 | Studime e Epërme | 70202020 | 723 | 84 | 24 |
| 17 | Stanoc i Epërme | 70202021 | 809 | 73 | 33 |
| 18 | Gracë | 70202022 | 458 | 99 | 51 |
| 19 | Gumnishtë | 70202023 | 975 | 4 | 37 |
| 20 | Dobërlluk | 70202024 | 310 | 93 | 57 |
| 21 | Dalak | 70202025 | 108 | 88 | 19 |
| 22 | Dumnicë e Poshtme | 70202026 | 677 | 23 | 57 |
| 23 | Studime e Poshtme | 70202027 | 440 | 96 | 3 |
| 24 | Stanoc i Poshtëm | 70202028 | 346 | 43 | 56 |
| 25 | Svaraçak i Poshtëm | 70202029 | 447 | 19 | 59 |
| 26 | Druar | 70202030 | 819 | 20 | 55 |
| 27 | Duboc | 70202032 | 987 | 60 | 52 |
| 28 | Zhilivodë | 70202033 | 470 | 30 | 63 |
| 29 | Zagorë | 70202034 | 388 | 10 | 59 |
| 30 | Jezere | 70202035 | 416 | 30 | 73 |
| 31 | Karaçë | 70202036 | 304 | 9 | 1 |
| 32 | Kollë | 70202037 | 718 | 23 | 14 |
| 33 | Kunovik | 70202038 | 170 | 11 | 94 |
| 34 | Kurillovë | 70202039 | 506 | 27 | 72 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 35 | Dumnicë e Llugës | 70202040 | 718 | 97 | 76 |
| 36 | Mihaliq | 70202041 | 117 | 132 | 0.65 |
| 37 | Miraçë | 70202042 | 271 | 76 | 88 |
| 38 | Nedakoc | 70202043 | 801 | 4.3 | 6 |
| 39 | Novolan | 70202044 | 727 | 83 | 19 |
| 40 | Begaj | 70202045 | 217 | 98 | 2 |
| 41 | Maxhunaj | 70202046 | 682 | 26 | 57 |
| 42 | Akrashticë | 70202047 | 415 | 56 | 61 |
| 43 | Oshlan | 70202048 | 449 | 10 | 44 |
| 44 | Pantinë | 70202049 | 484 | 38 | 31 |
| 45 | Pasomë | 70202050 | 633 | 86 | 21 |
| 46 | Pestovë | 70202051 | 426 | 36 | 69 |
| 47 | Prelluzhë | 70202053 | 745 | 99 | 72 |
| 48 | Reznik | 70202054 | 357 | 18 | 65 |
| 49 | Ropicë | 70202055 | 192 | 74 | 97 |
| 50 | Samadrexhë | 70202056 | 1144 | 65 | 39 |
| 51 | Skoçan | 70202058 | 479 | 29 | 2 |
| 52 | Skromë | 70202059 | 692 | 70 | 78 |
| 53 | Sllakoc | 70202060 | 776 | 94 | 35 |
| 54 | Sllatinë | 70202061 | 413 | 59 | 35 |
| 55 | Smrekonicë | 70202062 | 424 | 37 | 73 |
| 56 | Stroc | 70202063 | 578 | 85 | 41 |
| 57 | Taraxhë | 70202064 | 270 | 93 | 31 |
| 58 | Tërllobuq | 70202065 | 373 | 32 | 35 |
| 59 | Hercegovë | 70202067 | 433 | 84 | 35 |
| 60 | Ceceli | 70202068 | 795 | 96 | 52 |
| 61 | Shalë | 70202069 | 724 | 17 | 34 |
| 62 | Shlivovicë | 70202070 | 613 | 96 | 42 |
| 63 | Shtitaricë | 70202071 | 179 | 77 | 5 |
| 64 | Beçiq | 70215006 | 329 | 43 | 38 |
| 65 | Galicë | 70215013 | 443 | 35 | 38 |
| | | Gjithësej: | 31429 | 22 | 39 |

**Neni 5**
**Subjekti përgjegjës për hartim**

Bartës i hartimit të Planit Zhvillimor Komunal caktohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit .

**Neni 6**
**Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim**

Mjetet për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal sigurohen nga buxheti i Komunës së Vushtrrisë. Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit koordinon procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal me drejtoritë sektorale dhe burimet njerëzore brenda komunës.

**Neni 7**
**Afati i hartimit**

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi është i obliguar që dokumentin e planifikimit hapësinor të hartojë në afat prej 12 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

**Neni 8**
**Konsultimet publike**

Projekti i Planit Zhvillimor Komunal para finalizimit duhet të vihet në konsultime publike dhe shqyrtim publik, paraqitja e Planit Zhvillimor Komunal në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallet përmes njoftimeve publike.

**Neni 9**
**Afati i Vlefshmërisë**

Dokumenti i planifikimit hapësinor, Plani Zhvillimor Komunal hartohet për periudhën kohore 8 (tetë) vjeçare.

**Neni 10**
**Gjuha zyrtare**

Dokumenti i planifikimit (PZHK) sipas nenit 1 të këtij vendimi duhet të jetë në gjuhë zyrtare të Komunës dhe së paku 3 Kopje të shtypura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

**Neni 11**
**Programimi**

Pjesë e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit i paraparë në nenin 11 pika 1.3 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174.

**Neni 12**
**Hyrja në fuqi**

Ky Vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**14.** Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim-vendimit për ofrimin e mbështetjes financiare për shërim për z.Nasuf Aliu;

**Pas shqyrtimi të kësaj pike të rendit të ditës kuvendit pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim z. Nasuf Aliu, anëtar i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë i ofrohet mbështetje financiare në shumë prej tremijë euro (3000.00 €) për nevoja të shërimit nga një sëmundje serioze që është diagnostikuar kohëve të fundit.

2. Mjetet financiare të cekur në pikën paraprake të këtij vendim do të sigurohen nga buxheti i komunës – kategoria subvencione dhe transfere, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe në drejtoritë tjera komunale aty ka mjete të lira nga po e njëjta kategori buxhetore.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtorit tjera kompetente komunale.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**15.** Shqyrtimi i propozimit për ofrimin e ndihmës financiare për bizneset që operojnë në sheshin "Adem Jashari" vendi ku po ndërtohet parkingu nëntokësor;

**Pas shqyrtimi të kësaj pike të rendit të ditës kuvendit pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijon:**

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më datë: **28 dhjetor 2023**, duke marrë për bazë propozimin e anëtarit të kuvendit z.Ymer Haradinaj, nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje përfaqësuar në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë**,** pasi ka shqyrtuar gjendjen e renduar të bizneseve që shtrihen përgjatë sheshit "Adem Jashari" ku është duke u ndërtuar realizuar projekti kapital <parking nëntokësor>, që është ndikuar veprimtaria e këtyre bizneseve dhe si rezultat i kësaj, pas një analize të hollësishme kryetari të komunës i parashtron këtë:

**<u>Rekomandim:</u>**

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë kërkon nga kryetari i komunës së Vushtrrisë, që të bëj një analizë të hollësishme buxhetore, që për vitin fiskal 2024, të iu ofrohet një ndihmë financiare, apo mbulimin i qirasë për bizneset që shtrihen përgjatë sheshit "Adem Jashari" në Vushtrri, konkretisht në pjesën ku po realizohet projekti <ndërtimi i parkingut nëntokësor>, pasi që bizneset që shtrihen në perimetrin ku po ndërtohet ky parking, janë dëmtuar si rezultat i zhvillimit të punimeve dhe mbylljes së rrugës e që në rastin konkret është zvogëluar qarkullimi i njerëzve dhe kësisoj është penguar dhe kufizuar në masë të madhe zhvillim i qarkullimit biznesor.

Prandaj bazuar në cekurat më lartë kuvendi, kërkon dhe rekomandon që kryetari i komunës të akordoj ndonjë subvencion-ndihmë financiare në varësi të modaliteti ligjor, apo që t'i propozoj kuvendi që në njërën nga mbledhjet e radhës, të aprovoj ndihmën financiare për këto biznese.

**16.** Pyetje dhe përgjigje.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit**- pyeti kryetarin e komunës për premtimin elektoral, që kishte dhënë për mësimdhënësit për pagesën e shujtave dhe të drejtave tjera që dalin nga Kontrata Kolektive. Në këtë ceku se kanë fillua ti marrin këto pare, po janë dëmtuar nga avokatet dhe përmbaruesi dhe për këtë kërkoj të di se kryetari i komunës a do të i kërkoj falje mbi 1000 mësimdhënësve, të cilëve iu kishte premtuar se do ti mbuloj këto pagesa pa shkuar në gjykatë. Mandej me këtë marrëveshje është dëmtuar edhe komuna nga kjo marrëveshje tinëzare e kryetarit të komunës. Më tej nëse thirreni në sindikatë, kjo nuk është legjitime sepse ka rënë numri i atyre që janë të anëtarësuar në sindikatë. Mandej konstatimi se është shpenzuar 94% e buxheti të komunës nuk është i qëndrueshëm për fatin se nëse hiqet shuma prej 2,100.000 € që janë dedikuar për mësimdhënësit atëherë del se shpenzimi i buxheti është në masën 70%. Prandaj shtoj se mësimdhënësit e komunës janë dëmtuar nga premtimi dhe marrëveshja e kryetarit të komunës z.Ferit Idrizi. Me tej shtoj se dy ankesa i ka parashtruar z.Bastri Duraku, por më vonë kryetari kur e ka parë vendimin e Gjykatës Suprem, atëherë është kthyer për 180 shkallë duke lidh marrëveshje për të realizuar kinse të drejta e mësimdhënësve, por në realitet i ka dëmtuar.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**sqaroi se pas ushtrimit të padive zyra ligjore e komunës, nuk ka tjetër detyrë për pos që të bëj ankesë. Pastaj shtoj se ka qenë në negociata përmes ndërmjetësimit, dhe momentin kur është arritur marrëveshja ne i kemi tërhequr të gjitha ankesat prej gjykatës. Lidhur me kërkim faljen shtoj se ai kërkon falje atëherë kur ka bazë, por jo kur atë e kërkon dikush. Ai i përgëzoj të gjithë mësimdhënësit dhe shprehi kancerin që ka arritur të iu paguaj për të drejtat që iu takojnë me kontratë, sepse komunat tjera nuk kanë mundur të përmbushin këto obligime. Si rezultat i mungesës së vijës buxhetore mjetet janë marr nga investimet kapitale, por ne nuk kemi pasur tjetër zgjidhje. Pretendimi se është dëmtuar mësimdhënësit është i pavërtetë sepse ato pare i ka paguar komuna. Ndërsa heqja dorë nga kamata prej 8% ka bërë që komuna ti shpëtoj rreth 1 milion euro.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**pyeti kryesuesen e kuvendit se bazuar në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, lidhur me ligjin e pagave ku thuhet për shtesat për funksionar publik që kryejnë punën e njëjtë dhe nuk paguhen njëjtë, andaj rekomandoj që kryesuesja ta adresoj këtë çështje se ky nenë i aktgjykimit a vlen edhe për anëtarët e kuvendit që paguhen ndryshe si rezultat se kanë edhe një punë tjetër që paguhet nga buxheti i Republikës së Kosovës.
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**paraqiti vërejtje se në seancën e kaluar ka adresuar katër pyetje por që nuk ka marrë përgjigje, kërkoj që për mbledhjen e radhës ti dërgohen përgjigjet.

**Mbledhja përfundoi në ora: 15:40.**

| | |
|---|---|
| **Bastri Duraku** | **Melihate Basholli-Latifi** |
| ________________ | ___________________________ |
| **Procesmbajtës** | **Kryesuese e Kuvendit** |

REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA VUSHTRRI

| | |
|---|---|
| **DATA/DATUM/DATE** | 05.01.2024 |
| **PËR/ZA/TO:** | Komiteti për Politik dhe Financa-Kuvendin Komunal |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH** | Kryetarit të Komunës z. Ferit Idrizi |
| **Nga/OD/FROM** | Isuf Jashari, Drejtor i Financave |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Raporti i shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2023 |

Të nderuar

Duke u bazuar në planin e punës për vitin 2023 Drejtoria për Buxhet, Thesar dhe Financa ju prezanton Raportin Janar-Dhjetor 2023 ,Raporti është i bazuar në planin buxhetor dhe planin e rrjedhës së parasë publike për vitin 2023,sipas kërkesave të drejtoreve të drejtorive gjegjëse.

Shtojcë:

Raportet fizike

K.K.Vushtrri

644

Periudha raportuese Janar - Dhjetor

## TE HYRAT VETANAKE (THV) SIPAS DREJTORIVE DHE KODIT EKONOMIK

| Përshkrimi | Kodi | Periudha raportuese | | | Vjetore | | | | Viti i kaluar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Buxheti i planifikuar për PR | Të hyrat e realizuar në PR | Përqindja e buxhet të realizuar për PR | Buxheti I planifikuar për 2023 | Buxheti I mbetur për 2023 | Plani I reviduar | #REF! | Te hyrat e realizuara ne periudhen e njejte 2022 |
| | | 4 | 5 | 6 = 5/4*100 | 7 | 8= 7-5 | 9 | 10 = 7-9 | 11 |
| **Administrata dhe personeli** | **163** | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Taksa administr | | 100,000.00 | 71,610.00 | **72%** | 100,000.00 | **28,390.00** | 0.00 | **100,000.00** | 76,279.00 |
| **TOTAL** | | **100,000.00** | **71,610.00** | **72%** | **100,000.00** | **28,390.00** | **0.00** | **100,000.00** | **76,279.00** |
| | | | | | | | | | |
| **Buxhet dhe Financa** | **175** | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Taksat e firmave | | 15,000.00 | 15,000.00 | **100%** | 15,000.00 | **0.00** | 0.00 | **15,000.00** | 18,750.00 |
| Tatimi në pronë | | 1,152,144.00 | 1,268,599.19 | **110%** | 1,152,144.00 | **-116,455.19** | 0.00 | **1,152,144.00** | 969,622.63 |
| **TOTAL** | | **1,167,144.00** | **1,283,599.19** | **110%** | **1,167,144.00** | **-116,455.19** | **0.00** | **1,167,144.00** | **988,372.63** |
| | | | | | | | | | |
| **Arsimi** | **900** | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Shitja e produkteve bujq. | | | 908.83 | **#DIV/0!** | | **-908.83** | 0.00 | **0.00** | 528.60 |
| Participimi në çe | | 60,000.00 | 67,759.00 | **113%** | 60,000.00 | **-7,759.00** | 0.00 | **60,000.00** | 41,785.00 |
| Shkolla e Mesme | | 15,000.00 | 22,809.00 | **152%** | 15,000.00 | **-7,809.00** | 0.00 | **15,000.00** | 15,073.00 |
| Shkolla e Mesme | | 14,000.00 | 17,970.00 | **128%** | 14,000.00 | **-3,970.00** | 0.00 | **14,000.00** | 17,020.00 |
| **TOTAL** | | **89,000.00** | **109,446.83** | **123%** | **89,000.00** | **-20,446.83** | **0.00** | **89,000.00** | **74,406.60** |
| | | | | | | | | | |
| **Gjeodezi dhe Kadastër** | **650** | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Matjet e tokave | | 70,000.00 | 141,911.83 | | 70,000.00 | **(71,911.83)** | | **70,000.00** | 126,420.50 |
| Qiraja nga objek | | 23,000.00 | 18,987.21 | **83%** | 23,000.00 | **4,012.79** | 0.00 | **23,000.00** | 2,155.00 |
| **TOTAL** | | **93,000.00** | **160,899.04** | **173%** | **93,000.00** | **-67,899.04** | **0.00** | **93,000.00** | **128,575.50** |
| | | | | | | | | | |
| **Kulturë, rini dhe sport** | **850** | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Palestra e sporti | | 1,000.00 | 624.00 | **62%** | 1,000.00 | **376.00** | 0.00 | **1,000.00** | 288.00 |
| Biblioteka | | 500.00 | 121.00 | **24%** | 500.00 | **379.00** | 0.00 | **500.00** | 140.00 |
| Shtëpia e Kultur | | 1,000.00 | | **0%** | 1,000.00 | **1,000.00** | 0.00 | **1,000.00** | 161.40 |
| **TOTAL** | | **2,500.00** | **745.00** | **30%** | **2,500.00** | **1,755.00** | **0.00** | **2,500.00** | **449.40** |
| | | | | | | | | | |
| **Shërbime publike** | **180** | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Parkingjet | | 2,000.00 | 2,030.00 | **102%** | 2,000.00 | **-30.00** | 0.00 | **2,000.00** | 5,002.30 |
| Regjistrimi I aut | | 120,000.00 | 151,601.50 | **126%** | 120,000.00 | **-31,601.50** | 0.00 | **120,000.00** | 136,402.00 |
| Taksat e mbetur | | 756,000.00 | 543,102.83 | **72%** | 756,000.00 | **212,897.17** | 0.00 | **756,000.00** | 438,997.05 |
| **TOTAL** | | **878,000.00** | **696,734.33** | **79%** | **878,000.00** | **181,265.67** | **0.00** | **878,000.00** | **580,401.35** |
| **Bujqsia** | 470 | | | | | | | | |
| | | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Shitja e Drujve | | | | **0%** | | **0.00** | 0.00 | **0.00** | 945.00 |
| Ndryshimi i dest | | 15,000.00 | 77,902.70 | **519%** | 15,000.00 | **-62,902.70** | 0.00 | **15,000.00** | 51,629.00 |
| Leje pune | | | 60.00 | **#DIV/0!** | | **-60.00** | 0.00 | **0.00** | 3,720.00 |
| **TOTAL** | | **15,000.00** | **77,962.70** | **520%** | **15,000.00** | **-62,962.70** | **0.00** | **15,000.00** | **56,294.00** |
| | | | | | | | | | |
| **Shëndetësi** | **700** | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Participim | | 50,000.00 | 56,065.23 | **112%** | 50,000.00 | **-6,065.23** | 0.00 | **50,000.00** | 51,760.50 |
| Paricipim QPS | | 2,000.00 | 3,975.00 | **199%** | 2,000.00 | **-1,975.00** | 0.00 | **2,000.00** | 3,830.00 |
| **TOTAL** | | **52,000.00** | **60,040.23** | **115%** | **52,000.00** | **-8,040.23** | **0.00** | **52,000.00** | **55,590.50** |
| | | | | | | | | | |
| **Ispeksioni** | **166** | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Pranime teknike | | 5,000.00 | 8,070.00 | **161%** | 5,000.00 | **-3,070.00** | 0.00 | **5,000.00** | 7,035.00 |
| Gjobat e inspeks | | 5,000.00 | 7,600.00 | **152%** | 5,000.00 | **-2,600.00** | 0.00 | **5,000.00** | 2,200.00 |
| **TOTAL** | | **10,000.00** | **15,670.00** | **157%** | **10,000.00** | **-5,670.00** | **0.00** | **10,000.00** | **9,235.00** |

| Urbanizmi | 660 | € | € | % | € | € | € | € | € |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Lejet e ndërtimi | | 423,915.00 | 771,491.23 | 182% | 423,915.00 | -347,576.23 | 0.00 | 423,915.00 | 508,826.74 |
| leje mjedisore | | 50,000.00 | 113,076.90 | | 50,000.00 | -63,076.90 | 0.00 | 50,000.00 | 29,196.82 |
| Legalizim i Obje | | 15,000.00 | 25,663.86 | | 15,000.00 | -10,663.86 | 0.00 | 15,000.00 | 16,194.82 |
| Rrenim i objekteve | | | 852.60 | | | -852.60 | 0.00 | 0.00 | 2,437.68 |
| Shfrytëzimi i pr | | 5,000.00 | 10,977.50 | 220% | 5,000.00 | -5,977.50 | 0.00 | 5,000.00 | 9,954.20 |
| **TOTAL** | | **493,915.00** | **922,062.09** | **187%** | **493,915.00** | **-428,147.09** | **0.00** | **493,915.00** | **566,610.26** |
| | | | | | | | | | |
| | 850 | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Gjobat e pyjeve | | | 2,161.65 | | | | | | 250.00 |
| Të hyrat tjera | | | 6,467.28 | #VALUE! | | -6,467.28 | 0.00 | 0.00 | 30,365.00 |
| **TOTAL** | | **0.00** | **8,628.93** | **#DIV/0!** | **0.00** | **-6,467.28** | **0.00** | **0.00** | **30,615.00** |
| | | | | | | | | | |
| | | **2,900,559.00** | **3,407,398.34** | **117%** | **2,900,559.00** | **-506,839.34** | **0.00** | **2,900,559.00** | **2,566,829.24** |

Sqarim:Buxheti i planifikuarnga të hyrat vetanake gjat periudhes Janar-Dhjetor 2023 është 2,900,559.00euro
Realizimi është 3,407,398.34 euro ,shprehur në përqindje 17% është tejkalimi.
Në raport me periudhen e njejt të vitit të kaluar ka tejkalim 32.74%

| #REF! | K.K.Vushtrri |
|---|---|
| #REF! | 644 |
| Periudha raportuese | Janar - Dhjetor2023 |

## PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS BURIMIT TË FINANCIMIT

| PËRSHKRIMI | KODI | PERIUDHA RAPORTUESE | | | VJETORE | | | | Viti I kaluar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | BUXHETI I PLANIFIIKUAR | Shpenzimet të realizuar në PR | Përqindja e nuxhetit të alokuar | Buxheti I planifikuar për 2023 | Buxheti I mbetur për 2023 | Plani I reviduar 2023 | Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar | Shpenzimi I realizuar për periudhën e njëjtë 2022 |
| | | 4 | 5 | 6 = 5/4*100 | 7 | 8= 7-5 | 9 | 10 = 7-9 | 11 |
| | | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Finacimi nga huamarrjet | 04 | | | 0% | | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 158,055.91 |
| Granti Qeveritar | 10 | 21,843,709.83 | 21,241,894.59 | 97% | 21,843,709.83 | 601,815.24 | 0.00 | 21,843,709.83 | 15,284,214.97 |
| Të hyrat vetanake | 21 | 2,900,559.00 | 2,428,384.86 | 84% | 2,900,559.00 | 472,174.14 | 0.00 | 2,900,559.00 | 1,399,805.00 |
| Mjetet e bartura | 22 | 2,733,627.37 | 2,569,782.34 | 94% | 2,733,627.37 | 163,845.03 | 0.00 | 2,733,627.37 | 1,427,598.28 |
| Donacionet e brendshme | 31 | 5,471.23 | 1,848.00 | 34% | 5,471.23 | 3,623.23 | 0.00 | 5,471.23 | 46,530.00 |
| Donacionet e jashtme | 32 | 19,686.17 | | 0% | 19,686.17 | 19,686.17 | 0.00 | 19,686.17 | 22,413.22 |
| TOTALI | | 27,503,053.60 | 26,241,909.79 | 95% | 27,503,053.60 | 1,261,143.81 | 0.00 | 27,503,053.60 | 18,338,617.38 |

Sqarim:Përmbledhja e shpenzimeve sipas burimit të financimit sipas kategorive ekonomike është si vijon:

**Granti Qeveritar për periudhen Janar-Dhjetor 2023,planifikimi është 21,843,709.83euro,Realizimi është 21,241,894.59eur,përqindja e realizimit 97%**

Kategoria Të Hyrat vetanake fondi 21 për periudhen Janar-Dhjetor 2023,planifikimi është 2,900,559.00 euro,Realizimi I shpenzimit shuma 2,428,384.86euro. Realizimi 84%

Kategoria Të Hyrat vetanake fondi 22 për periudhen Janar-Dhjetor 2023,planifikimi është 2,733,627.37 euro,Realizimi I shpenzimit shuma 2,569,782.34euro. Realizimi 94%

Donacionet e brendeshme të planifikuara jonë 5,471.23euro,të realizuara janë 1,848.00euro apo shprehur në % realizimi 34% dhe

Donacionet e jashtmebarten në vitin 2024

Totali I planifikimit në këto kategori ekonomike është 27,503,053.60.Realizimi I shpenzimeve është 26,241,909.79 euro,Realizimi 95%

| | |
|---|---|
| **Komuna** | **VUSHTRRI** |
| **Kodi** | **644** |
| **Periudha raportuese** | **Janar - Dhjetor2023** |

## PËRMLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE TË LARTA TË SHPENZIMEVE

| PËRSHKRIMI | KODI | PERIUDHA RAPORTUESE | | | VJETORE | | | | Viti I kaluar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | BUXHETI I PLANIFIIKUAR | Shpenzimet të realizuar në PR | Përqindja e nuxhetit të alokuar | Buxheti I planifikuar për 2023 | Buxheti I mbetur për 2023 | Plani I reviduar 2023 | Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar | Shpenzimi I realizuar për periudhën e njëjtë 2022 |
| | | 4 | 5 | 6 = 5/4*100 | 7 | 8= 7-5 | 9 | 10 = 7-9 | 11 |
| | | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Paga dhe mëditje | 111 | 12,166,731.83 | 12,141,455.83 | 100% | 12,166,731.83 | 25,276.00 | 0.00 | 12,166,731.83 | 10,100,513.53 |
| Mallra dhe shërbime | 130 | 4,687,019.58 | 4,419,302.10 | 94% | 4,687,019.58 | 267,717.48 | 0.00 | 4,687,019.58 | 3,317,493.01 |
| Shpenzimet komunale | 132 | 483,590.20 | 447,458.24 | 93% | 483,590.20 | 36,131.96 | 0.00 | 483,590.20 | 381,074.87 |
| Subvencionet dhe transferet | 200 | 1,153,155.43 | 1,129,213.10 | 98% | 1,153,155.43 | 23,942.33 | 0.00 | 1,153,155.43 | 1,183,529.05 |
| Investimet kapitale | 300 | 9,012,556.56 | 8,103,301.54 | 90% | 9,012,556.56 | 909,255.02 | 0.00 | 9,012,556.56 | 3,356,006.92 |
| **TOTALI** | | **27,503,053.60** | **26,240,730.81** | **95%** | **27,503,053.60** | **1,262,322.79** | **0.00** | **27,503,053.60** | **18,338,617.38** |

Sqarim:Sipas kategorive të shpenzimeve buxheti I planifikuar për periudhen Janar-Dhjetor 2023.
Realizimi është 27,503,053.60.Realizimi I shpenzimeve është 26,240,730.81 euro,Realizimi 95%.

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Emri i Komunës :** | | **VUSHTRRI** | | | | | | | |
| **Kodi i Komunës:** | | **644** | | | | | | | |
| | | **Janar - Dhjetor2023** | | | | | | | |
| **Periudha raportuese** | | | | | | | | | |

## PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS DREJTORIVE

| PËRSHKRIMI | KODI | PERIUDHA RAPORTUESE | | | VJETORE | | | | Viti I kaluar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | BUXHETI I PLANIFIIKUAR | Shpenzimet të realizuar në PR | Përqindja e nuxhetit të alokuar | Buxheti I planifikuar për 2023 | Buxheti I mbetur për 2023 | Plani I reviduar 2023 | Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar | Shpenzimi I realizuar për periudhën e njëjtë 2022 |
| | | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Zyra e Kryetarit | 160 | 585,249.44 | 572,082.49 | 98% | 427,406.00 | -144,676.49 | 0.00 | 427,406.00 | 370,896.13 |
| Administrata dhe personeli | 163 | 533,851.02 | 512,490.33 | 96% | 539,052.93 | 26,562.60 | 0.00 | 539,052.93 | 561,569.19 |
| Inspektimet | 166 | 132,691.39 | 130,035.59 | 98% | 137,683.00 | 7,647.41 | 0.00 | 137,683.00 | 90,006.24 |
| Prokurimi | 167 | 50,058.01 | 48,998.76 | 98% | 55,360.93 | 6,362.17 | 0.00 | 55,360.93 | 31,985.72 |
| Zyra e Kuvendit Komunal | 169 | 265,641.45 | 265,331.43 | 100% | 142,264.99 | -123,066.44 | 0.00 | 142,264.99 | 136,726.56 |
| Buxheti dhe financat | 175 | 188,410.59 | 185,119.68 | 98% | 199,918.00 | 14,798.32 | 0.00 | 199,918.00 | 168,331.28 |
| Shërbimet publike, Mbrojtja civile dhe emergjenca | 180 | 5,335,296.64 | 5,085,423.41 | 95% | 5,146,510.16 | 61,086.75 | 0.00 | 5,146,510.16 | 3,106,846.73 |
| Zyra lokale e komuniteteve | 195 | 75,806.71 | 72,251.72 | 95% | 70,079.00 | -2,172.72 | 0.00 | 70,079.00 | 55,279.92 |
| Bujqësi, pylltari, zhvillimi rural | 470 | 1,271,998.41 | 1,237,814.36 | 97% | 698,112.92 | -539,701.44 | 0.00 | 698,112.92 | 543,019.14 |
| Gjeodezi dhe Kadastër | 650 | 80,534.71 | 77,586.15 | 96% | 94,183.00 | 16,596.85 | 0.00 | 94,183.00 | 75,274.48 |
| Planifikimi urban dhe mjedisi | 660 | 3,241,295.00 | 2,765,277.03 | 85% | 3,224,044.70 | 458,767.67 | 0.00 | 3,224,044.70 | 986,703.83 |
| Shëndetësia primare | 730 | 3,501,197.56 | 3,301,479.00 | 94% | 3,363,645.64 | 62,166.64 | 0.00 | 3,363,645.64 | 2,483,479.58 |
| Shërbimet sociale rezidenciale | | 317,251.78 | 281,983.93 | 89% | 325,104.38 | 43,120.45 | 0.00 | | 217,759.93 |
| Kulturë, rini, sport | 850 | 581,441.45 | 574,394.70 | 99% | 529,165.65 | -45,229.05 | 0.00 | 529,165.65 | 515,729.78 |
| Arsimi | 920 | 11,342,329.44 | 11,130,462.23 | 98% | 10,045,384.59 | -1,085,077.64 | 0.00 | 10,045,384.59 | 8,995,008.87 |
| **TOTALI** | | **27,503,053.60** | **26,240,730.81** | 95% | **24,997,915.89** | **-1,242,814.92** | **0.00** | **24,997,915.89** | **18,338,617.38** |

Sqarim:Sipas kategorive të shpenzimeve buxheti I planifikuar për periudhen Janar-Dhjetor 2023.
Realizimi është 27,503,053.60 Realizimi I shpenzimeve është 26,240,730.81 euro,Realizimi 95%.

Emri i Komunës : VUSHTRRI
Kodi I komunës: 644
Periudha raportuese Janar - Dhjetor 2022

| KODI | Mallrat dhe shërbimet | 2023 | 2022 |
|---|---|---|---|
| 13130 | Shpenzimet e udhetimit zyrtar brenda vendit | 2,858.22 | 4,262.81 |
| 13131 | Shpenzimet të vogla -para xhepi brenda vendit | 777.50 | |
| 13132 | Akomodimi I udhetimit zyrtar brenda vendit | 40.00 | |
| 13133 | Shpenzimet e tjera të-udhetimit zyrtar brenda vendit | 3,131.60 | 765.41 |
| 13140 | Shpenzimet e udhetimit zyrtar jasht vendit | 13,674.76 | 3,260.18 |
| 13141 | Shpenzimet të vogla -para xhepi | 7,935.34 | 7,652.40 |
| 13142 | Akomodimet e udhetimit zyrtar jasht vendit | 5,163.50 | 4,050.50 |
| 13143 | Shpenzimet tjera e udhetimit zyrtar jasht vendit | 12,532.57 | 1,731.72 |
| 13310 | Shpenzimet për internet | 4,678.05 | 4,874.42 |
| 13320 | Shpenzimet e telefonisë mobile | 20,585.07 | 22,502.05 |
| 13330 | Shpenzimet postare | 1,159.10 | 13,606.46 |
| 13410 | Shpenzimet e arsimit dhe trajnimit | 3,160.00 | 9,331.00 |
| 13420 | Sherbimet e perfaqsimit - avokaturë | 23,606.10 | 18,201.50 |
| 13430 | Shërbime te ndryshme shendetësore | 30,518.68 | 8,133.76 |
| 13440 | Shërbime te ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse | 52,652.02 | 541.00 |
| 13450 | Shërbime shtypje - jo marketing | | 976.50 |
| 13460 | Shërbime Kontraktuese Tjera | 2,775,663.52 | 2,002,496.30 |
| 13470 | Shërbime teknike | 8,479.75 | 1,800.00 |
| 13780 | Shpenzimet për antarsim | 17,480.50 | 17,480.50 |
| 13501 | Mobilje (më pak se 1000 euro) | 13,806.18 | 23,766.41 |
| 13503 | Kompjuter (më pak se 1000 euro) | 41,972.00 | 51,306.71 |
| 13504 | Harduer për teknikë informative (më pak se 1000 euro) | | 39.00 |
| 13509 | paisje tjera (më pak se 1000 euro) | 77,043.25 | 76,932.56 |
| 13610 | Furnizime për zyrë | 125,209.93 | 132,408.45 |
| 13611 | Furnizim me dokumenta bllanko | 3,000.00 | |
| 13620 | Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare) | 146,157.05 | 149,124.13 |
| 13630 | Furnizime mjekësore | 92,560.42 | 98,133.88 |
| 13640 | Furnizime pastrimi | 29,847.58 | 38,585.15 |
| 13650 | Furnizim me veshmbathje | 26,116.82 | 14,206.50 |
| 13655 | Furnizim me preparate kimike | 2,483.00 | 2,395.00 |
| 13710 | vaj | 972.00 | 1,593.00 |
| 13720 | Nafte per ngrohje qendrore | 53,820.48 | 72,721.01 |
| 13730 | Vaj për ngrohje | 1,272.00 | |
| 13760 | Dru | 238,217.50 | 211,248.75 |
| 13770 | Derivate per gjenerator | 4,791.15 | 5,462.79 |
| 13780 | Karburant per vetura | 55,053.82 | 62,998.48 |
| 13790 | Gas natyror | | 1,276.80 |
| 13810 | Avanc për para të imta | 4,100.00 | 1,000.00 |
| 13820 | Avanc për udhëtime zyrtare | 28,438.06 | 30,162.83 |
| 13918 | Provizion për tarifa të ndryshme | 17,085.44 | 4,911.00 |
| 13919 | Provizion bankar TEB | 331.50 | |
| 13950 | Regjistrimi i automjeteve | 4,935.00 | 4,635.00 |
| 13951 | Sigurimi i automjeteve | 11,634.90 | 9,353.61 |
| 14010 | Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve | 41,577.26 | 27,629.24 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 14020 | Mirembajtja e ndertesave | 3,493.04 | 8,453.47 |
| 14022 | Mirembajtja e ndertesave afariste | | |
| 14023 | Mirembajtja e shkollave | 17,248.00 | 20,515.51 |
| 14024 | Mirmbajtja e objekteve shëndetësore | 655.24 | 3,108.94 |
| 14040 | Mirmbajtja e teknologjisë informative | 1,009.96 | 5,165.09 |
| 14050 | Mirembajtja e mobileve dhe paisjeve | 54,555.90 | 15,162.07 |
| 14060 | Mirembajtja rutinore | | 14,816.00 |
| 14110 | Qiraja per ndertesa | 1,800.00 | 1,620.00 |
| 14120 | Qiraja për tokë | 432.00 | |
| 14130 | Qiraja - pajisjet | 15,757.72 | 13,294.26 |
| 14140 | Qiraja -makineria | 16,241.64 | 20,036.48 |
| 14210 | Reklamat dhe konkurset | 2,683.00 | |
| 14220 | Botimet e publikimeve | 1,788.00 | 5,485.50 |
| 14230 | Shpenzimet per informim publik | 10,948.80 | 9,927.80 |
| 14310 | Drekat zyrtare | 44,606.35 | 39,438.15 |
| 14410 | Shpenzime-vendimet e gjykatave | 245,611.81 | 18,612.93 |
| 14415 | Pagesat për tarifat-vendimet gjyqësore- përmbarimore | | 300.00 |
| | **13 TOTALI PËR MALLRA DHE SHËRBIME** | **4,421,353.08** | **3,317,493.01** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **14** | | | |
| 13210 | Rryma | 306,652.25 | 293,862.17 |
| 13220 | Uji | 70,697.44 | 50,708.95 |
| 13230 | Mbeturinat | 35,308.01 | 29,262.92 |
| 13250 | Shpenzimet telefonike | 8,100.54 | 7,090.83 |
| 13260 | Pagesa-vendime gjygjësore | 26,700.00 | 150.00 |
| | **14 TOTALI I SHPENZIMEVE KOMUNALE** | **447,458.24** | **381,074.87** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **20** | **SUBVENCIONET** | | |
| 21110 | SUBVENCIONE PËR ENTITETET PUBLIKE | 536,455.36 | 444,983.24 |
| 21120 | SUBVENCIONE PËR ENTITETET PUBLIKE KULTURORE | 3,100.00 | |
| 21200 | SUBVENCIONE PËR ENTITETET JOPUBLIKE | 580,683.35 | 696,568.33 |
| 22300 | VENDIMET GJYQESORE | 8,974.39 | |
| | **20 TOTALI I SUBVENCIONEVE** | **1,129,213.10** | **1,141,551.57** |
| | TOTALI I SHPENZIMEVE OPERATIVE | 5,998,024.42 | 4,840,119.45 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 53057 RENOVIMI I SHFMU - LUMMADH | 52913 NDËRTIMI I DEPOSË PËR SHFMU "MIGJENI" STANOC | 7,000.00 | 6,637.00 | 363.00 | 94.81 |
| SHFMU 'ADEM VOCA " | 52961 NDERTIMI I DEPOSE PER SHFMU "ENVER HADRI" SMREKONICE | 7,000.00 | 6,721.00 | 279.00 | 96.01 |
| QERDHES FOLEJA 1- | 52967 NDËRTIMI I DEPOSË PËR SHF "ALI KELMENDI" VUSHTRRI | 8,000.00 | 7,226.20 | 773.80 | 90.33 |
| 53066 RRETHOJA PËR QERDHEN 2 | 52995 NDËRTIMI I DEPOSE PËR SHFMU "7 MARSI" BUKOSH | 4,000.00 | 3,795.30 | 204.70 | 94.88 |
| DEPOSË PËR FOLEJA | 53000 NDËRTIMI I DEPOSE PËR SHFMU "AVDYL FRASHËRI" DRUAR | 4,000.00 | 3,814.30 | 185.70 | 95.36 |
| 53072 NDËRTIMI I DEPOSË PËR FOLEJA II | 53010 RRETHOJA DHE MURI MBROJTËS SHFMU - BAJRAM CURRI - DUMNICË | 10,000.00 | 10,000.00 | 0.00 | 100.00 |
| TEKNOLOGJI | 53024 NDËRTIMI I SHFMU "MUSTAF VENHARI " | 90,000.00 | 90,000.00 | 0.00 | 100.00 |
| PLATOS PËR SHFMU | 53032 RENOVIMI I SHFMU "LATIF BERISHA" DOBERLLUKE | 30,000.00 | 24,471.82 | 5,528.18 | 81.57 |
| PAIJISJEVE PER | 53051 RENOVIMI I SHFMU "LIRIA " STROC GLLAVOTIN | 25,000.00 | 21,900.46 | 3,099.54 | 87.60 |
| DEPOSË PËR SHFMU | 53052 RENOVIMI I SHFMU REZNIK | 15,000.00 | 14,360.00 | 640.00 | 95.73 |
| NDE FUSHES | 53053 RENOVIMI I SHFMU -MIHALIQ | 10,000.00 | 5,872.00 | 4,128.00 | 58.72 |
| MEREMETIMI I SHMU - 1 | 53054 RENOVIMI I SHFMU "RILINDJA" MAXUNAJ | 25,000.00 | 21,493.28 | 3,506.72 | 85.97 |
| SHKOLLES HAJRULLAH | 53055 RENOVIMI I SHF "ALI KËLMENDI" | 21,355.00 | 20,429.45 | 925.55 | 95.67 |
| NDE PUNETORISE DHE | 53057 RENOVIMI I SHFMU - LUMMADH | 15,000.00 | 15,000.00 | 0.00 | 100.00 |
| I SHKOLLES BAHRI | 53060 RENOVIMI I SHFMU "ADEM VOCA " PASOMË | 35,000.00 | 34,880.00 | 120.00 | 99.66 |
| FURNIZ MJETE PER | 53065 RENOVIMI I QERDHES FOLEJA 1- VUSHTRRI | 175,000.00 | 175,000.00 | 0.00 | 100.00 |
| **Totali I Përgjithshëm** | 53066 RRETHOJA PËR QERDHEN 2 | 29,000.00 | 28,999.92 | 0.08 | 100.00 |
| | 53069 NDËRTIMI I DEPOSË PËR FOLEJA III VUSHTRRI | 10,000.00 | 9,847.66 | 152.34 | 98.48 |
| | 53072 NDËRTIMI I DEPOSË PËR FOLEJA II | 10,000.00 | 9,806.79 | 193.21 | 98.07 |
| | 53074 TEKNOLOGJI INFORMATIVE PËR SHKOLLA | 40,000.00 | 37,029.00 | 2,971.00 | 92.57 |
| | 53533 NDËRTIMI I PLATOS PËR SHFMU "28 NËNTORI" VËRNICË | 15,000.00 | 11,531.00 | 3,469.00 | 76.87 |
| | 53688 BLERJA E PAIJISJEVE PËR PRAKTIKË SHMT "LUTFI MUSIQI" | 35,500.00 | 30,000.00 | 5,500.00 | 84.51 |
| | 53713 NDËRTIMI I DEPOSË PËR SHFMU "MARTIRËT" REZNIK | 4,000.00 | 3,765.30 | 234.70 | 94.13 |
| | 53967 NDE FUSHES SPORTIVE DHE RETHOJES NE SHMU ENVER HADRI SMREKON | 10,270.00 | 10,270.00 | 0.00 | 100.00 |
| | 53968 MEREMETIMI I SHMU - 1 VUSHTRRI | 7,950.00 | 4,719.15 | 3,230.85 | 59.36 |
| | 53969 RENOVIMI I SHKOLLES HAJRULLAH SHALA NE AKRASHTICE | 6,157.00 | 6,157.00 | 0.00 | 100.00 |
| | 53970 NDE PUNETORISE DHE KABINETEVE NE SHMT LUTFI MUSIQI VUSHTRRI | 16,992.00 | 0.00 | 16,992.00 | 0.00 |
| | 93222 RREGULLIMI I SHKOLLES BAHRI HAXHA | 577.05 | 0.00 | 577.05 | 0.00 |
| | 95104 FURNIZ.MJETE PER PUNTOR SALDATOR-AXHUSTATOREVE | 157.00 | 0.00 | 157.00 | 0.00 |
| | **Totali I Përgjithshëm** | **9,012,556.56** | **8,103,301.54** | **909,255.02** | **89.91** |

Sqarim:Përmbledhja e shpenzimeve sipas kategoris ekonomike në investime kapitale është si vijon:
Buxheti I planifikuar në investime kapitale për vitin 2023 është 9,012,556.56euro
,realizimi është 8,103,301.54euro,apo 89.91% realizimi
Mbetja për bartje në investime kapitale për vitin 2024 është 909,255.02 euro.

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA VUSHTRRI

---

**Për,** KPF dhe Kuvendin e Komunës
**Propozues,** Kryetari i Komunës ________
**Hartues,** Drejtoia për Shërbime Publike ________
**Çështja për shqyrtim,** propozim-vendim

---

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 5 paragrafi 9 i Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/2013 mbi Kriteret për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe Pjesëmarrjen e Komunave në Bordet e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit, nenin 36 paragrafi 1 të Rregullës Financiare të Ministrisë së Financave Nr. 01/2013 Shpenzimi i Parave Publike dhe nenin 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën ____________ 2024 merr këtë:

**V E N D I M**
**PËR NDARJE TË MJETEVE FINANCIARE NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE "PËRPARIMI" SH.A NË VUSHTRRI**

1. Me këtë vendim, ndahen mjete financiare nga buxheti i komunës – subvencione dhe transfere të vitit 2024, në shumë të përgjithshme prej 190,000.00 € (njëqindenëntëdhjetëmijë euro) për N.P.L "Përparimi" Sh.a. në Vushtrri (mbështetje financiare) për blerje të mjeteve të punës.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

3. Ky vendimi hyn në Fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolli të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli Latifi
Kryesuese e Kuvendit

# Arsyetim

Nga NPL "Përparimi" në Vushtrri kemi pranuar kërkesë për mbështetje financiare për blerje të mjeteve të punës – pajisjeve për mbledhje dhe bartje të mbeturinave në territorin e Komunës së Vushtrrisë pasi që kjo ndërmarrje tani ofron shërbimet e grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave. Për të ushtruar me sukses këtë veprimtari krahas shërbimeve tjera që i kryen, nevojiten mjete të punës të cilat nuk ka mundësi që të sigurohen me buxhetin e kësaj ndërmarrje.

Konsiderojmë se kjo kërkesë është e arsyeshme dhe duhet të mbështetet, andaj i propozojmë Kuvendit të komunës që t'a miratoj këtë propozim vendim si në dispozitiv.

**Republika e Kosovës** **Komuna e Vushtrrisë**

Për: KPF dhe Kuvendin e Komunës
Propozues: Kryetari i Komunës ____________
Hartues: Zyra e Kryetarit ____________
Tema: Propozim – vendim

---

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 19 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit të Komunës si dhe nenin 6 të Rregullores KKV nr. 08/20 për Dhënien e Dekoratave prot nr. 209/20 datë29.10.2020, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën ____________ 2024 merr këtë:

**V E N D I M**
**PËR NDARJE TË DEKORATËS "NDERI I QYTETIT"**

1. Në shenjë respekti, për akte të larta sakrifice dhe heroizmi për vendin, me titullin "Nderi i Qytetit" nderohen Heronjtë e Kosovës:

 1.1 **Enver Zymberi** – (post mortum)

 1.2 **Afrim Bunjaku** – (post mortum)

2. Dekoratat nga pika një e këtij vendimi i dorëzon Kryetari i Komunës familjarit të të dekoruarit.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli – Latifi
Kryesuese e Kuvendit

# A r s y e t i m

Sipas Rregullores KKV nr. 08/20 për Dhënien e Dekoratave prot nr. 209/20 datë 29.10.2020, citojmë: titulli "Nderi i Qytetit" iu ndahet personaliteteve të cilët kanë kryer akte të larta sakrifice dhe heroizmi për vendin. Ky titull iu ipet gjithashtu personaliteteve të cilët në kohë të vështira ndihmuan dhe kontribuuan për Lirinë e Kosovës.

Andaj bazuar në nenin 6 të Rregullores së sipërcituar i propozoj KPF-së që ta përkrahë këtë propozim dhe rekomandoj kuvendit të komunës për miratim.

Me respekt!

**Republika e Kosovës** **Komuna e Vushtrrisë**

Për: Kuvendin e Komunës
Propozues: Kryetari i Komunës ____________
Hartues: Zyra e Kryetarit ____________
Tema: Propozim – vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenitn 15 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, nenin 19, paragrafi 1, pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më ________2023, merr këtë:

VENDIM
PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË VENDIMIT

1.Me këtë vendim ndryshohet vendimi 01 Nr. 24/22 date.31.01.2022 për themelim të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, si vijon

1.1 Në paragrafin 1, pika 1.3, z.Albanez Tahiraj, caktohet anëtar i KKSB-së kurse z.Dardan Abazi, pushon të jetë anëtar i KKSB-së, sipas nenit 4, pika 1.9 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyra e kryetarit dhe Sekretaria e Kuvendit.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Melihate Basholli Latifi
Kryesuese e Kuvendit

A r s y e t i m

Vendimi 01 Nr.24/22 datës 31.01.2022 për themelim të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi ndryshohet në bazë të nenit 15 pika 1.1 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL Për Këshillat Komunale Për Siguri në Bashkësi. Propozimi për ndryshim të këtij vendimi është dhënë për arsyet si në vijim:

- Albanez Tahiraj, është zgjedhur Drejtor i ri në DKA, i cili poashtu duhet të jetë anëtar i KKSB-së sipas Udhëzimit Administrativ të cekur më lart.

Bazuar në të cekurat më sipër, i propozohet kuvendit të komunës që ta miratoj këtë propozim vendim si në dispozitiv.

**Republika e Kosovës** **Komuna e Vushtrrisë**

Për: Kuvendin e Komunës
Propozues: Kryetari i Komunës
Hartues: Zyra e kryetarit
Tema: Propozim – vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 19 par. 1 nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën ____________ 2024 merr këtë:

# V E N D I M
# PËR SHFUQIZIM TË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

1. Shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 157/23 datë 29.06.2023 për miratimin e Planit Komunal për Integritet për periudhën 2023-2025.

2. Obligohet kryetari i komunës që të merr masat e nevojshme për të miratuar Planin Komunal për Integritet për periudhën 2024-2026.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi pushon të vlej vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 157/23 datë 29.06.2023 si dhe Plani Komunal për Integritet 2023-2025.

4. Vendimi hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë dhe do të zbatohet nga data 01.09.2022.

Melihate Basholli Latifi
Kryesuese e Kuvendit

# A r s y e t i m

Bazuar në dispozitat e Ligjit për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit Nr. 08/L-017, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit me datën 26.07.2023 ka miratuar Metodologjinë për Planet e Integritetit dhe ka obliguar institucionet publike të Kosovës që 6 muaj nga dita e publikimit të vendimit, të miratojnë planet e tyre të integritetit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal përmes shkresës nr. 0-893 datë 15.11.2023 ka kërkuar nga Kryetarët e Komunave që të hartojnë Planet e Integritetit deri në fund të viti 2023, bazuar në  Metodologjinë për Planet e Integritetit të aprovuar nga drejtori i AKK-së dhe t'i dërgojnë këto plane në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit për të konfirmuar nëse janë hartuar sipas Metodologjisë të AKK-së.

Planet e Integritet sipas MAPL-së dhe AKK-së duhet aprovohen nga Kryetarët e Komunave (shih shkresën njoftuese të MAPL-së) e jo siç ishte praktikë e viteve të kaluara që ato miratoheshin nga kuvendet e komunave.

Në respektim të rregullativës të cekur më sipër, Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, në muajin dhjetor 2023 ka themeluar grupin punues për hartim të draft planit të Integriteti për periudhën 2024-2026.

Ky draft plan tani është hartuar dhe është dërguar në Agjencinë Kundër Korrupsionit. Pas marrjes së pëlqimit nga  kjo agjenci do të miratohet nga Kryetari i Komunës.

Nga se u cek më sipër i propozohet kuvendit të komunës që t'a miratoj këtë propozim vendim si në dispozitiv.

Në mbështetje të Nenit 12, paragrafi 1, nën-paragrafët 1.5 dhe 1.9, Nenit 25, paragrafit 6, të Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për parandalimin e korrupsionit (*Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022*), Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 26.07.2023, nxjerr:

**V E N D I M**

01 1476/23
26.07.2023

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR PLANET E INTEGRITETIT**

1. Miratohet Metodologjia për Planet e Integritetit, sipas tekstit dhe shtojcave të bashkëngjitura këtij Vendimi, të cilat janë pjesë përbërëse të tij.

2. Obligohen të gjitha organet e administratës qendrore, agjencitë e pavarura si dhe autoritetet komunale, që të miratojnë planet e tyre të integritetit sipas Metodologjisë nga pika 1 e këtij Vendimi, gjashtë (6) muaj nga data e publikimit të Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Yll BULESHKAJ**

Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit

Vendimi iu dërgohet:

- *Të gjitha institucioneve të administratës qendrore, agjencive të pavarura, si dhe autoriteteve komunale;*
- *Arkivave;*

DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. 0-893
Data: 15.11.2023

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada - Government**
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 15.11.2023

**Për:** Kryetar të Komunave të Republikës së Kosovës

**Lënda:** Shkresë Njoftuese

***Të nderuar Kryetar të Komunave të Republikës së Kosovës,***

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, parmes kësaj shkrese ju njofton lidhur me obligimet ligjore të komunave që dalin nga neni 25, i Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

Me qëllim të zbatimit të dispozitave ligjore të nenit 25 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, autoritetet komunale duhet të hartojnë dhe aprovojnë *Planet e Integritetit*, jo më vonë se gjashtë muaj nga aprovimi i metodologjisë për hartimin e këtyre planeve.

Duke pasur parasysh së me datë 26 korrik 2023, është miratuar Metodologjia për Planet e Integritetit nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, kërkojmë nga Ju që t'i miratoni *Planet e Integritetit* dhe t'i përcillni në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit deri ne fund te vitit 2023.

Gjithashtu edhe Planet e Integritet të cilat janë hartuar nga Komunat para aprovimit të Metodologjisë së Planeve të Integritetit, duhet të njëjtat të përditësohen, në mënyrë që të njëjtat të jene në përputhje me Metodologjinë e Planeve te Integritet, të aprovohen dhe të dërgohen në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit. Aprovimi i Planeve të Integritetit sipas metodologjisë së re behet nga Kryetari i Komunës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në bashkëpunim me Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit është e gatshme t'ju ofrojë përkrahje dhe ndihmën e nevojshme, për zbatimin e plotë të obligimeve që dalin nga legjislacioni i zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

Me respekt,

**Jeton Qela,**

______________________________

**U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-së**

**Kopje:** *Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së*
*Yll Buleshka, Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit*
*Arkivit të MAPL-së*

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br 157/23
Nr. i fq. / Br. st -1-
Data: / Datum 29.06.2023
VUSHTRRI - VUČITRN

**Republika e Kosovës** **Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 19, pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **29 qershor 2023**, merr këtë:

**VENDIM**
**PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMUNAL PËR INTEGRITET**
**2023 – 2025**

**1.** Me këtë vendim miratohet Plani Komunal për Integritet 2023-2025 i Komunës së Vushtrrisë.

**2.** Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë me miratimin e këtij dokumenti synon që të vlerëson integritetin e punës, integritetin institucional, pajtueshmërinë dhe mënyrën se si institucioni dhe punonjësit e tij veprojnë përmes vetëvlerësimit të ekspozimit ndaj rreziqeve, ndaj ndodhjes dhe zhvillimit të korrupsionit dhe/ose sjelljeve tjera të papranueshme etike dhe profesionale.

**3.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin: Plani Komunal për Integritet 2023-2025 i Komunës së Vushtrrisë.

**4.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Kryetari i Komunës së Vushtrrisë.

**5.** Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**

Kryesuese e Kuvendit

**Republika e Kosovës** **Komuna e Vushtrrisë**

Për: Kuvendin e Komunës
Propozues: Për Kryetari i Komunës
Tema: Propozim vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 qershor 2008) nenin 7 të Ligjit për Bashkëpunim Ndër komunal Nr. 04/L-010 (Gazeta Zyrtare e Republikës Nr. 7/10 Gusht 2011), nenin 19 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit të Komunës Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më ________ 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet nisma e Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë 02Nr. 47/24 datë 23.01.2024 për bashkëpunim ndër komunal në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Komunave: Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Prishtinë dhe Podujevë, për realizim të projekteve me interes të përbashkët.

2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, miratohet propozim vendimi për financim të përbashkët të **studimit të fizibilitetit si dhe hartimit të projektit detaj/zbatues për ndërtimin e rrugës: Barilevë-Kozaricë-Dumnicë e Epërme-Kunovik-Vesekoc-Kurillovë-Bajgorë.**

3. Autorizohet Kryetari i Komunës së Vushtrrisë që të filloj konsultimet me Kryetarët e Komunave nga pika 1 (një) e këtij vendimi për të përgatitur Draftin e Marrëveshjes për bashkëpunim ndërkomunal për financim të përbashkët të studimit të fizibilitetit dhe hartimit të projektit detaj.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

5. Vendim iu dërgohet : MAPL-së dhe Kryetarëve të Komunave: Prishtinë, Mitrovicë e Jugut, Obiliq dhe Podujevë.

Melihate Basholli Latifi
Kryesuese e Kuvendit

A r s y e t i m

Miratimi i këtij vendimi për fillimin e konsultimeve me kryetarët e komunave të lartpërmendura për përgatitje të Draft marrëveshjes për financim të përbashkët të studimit të fizibilitetit si dhe hartimit të projektit detaj/zbatues për ndërtimin e rrugës: Barilevë-Kozaricë-Dumnicë e Epërme-Kunovik-Vesekoc-Kurillovë-Bajgorë vlerësohet të jetë i një rëndësie tejet të veçantë për banorët e zonave urbane të këtyre komunave duke ditur se pozita gjeografike e regjionit të Shalës është shumë e përshtatshme për turizëm malorë ku përveç ajrit të pastër dhe ujit të kualitetit të lartë, ky vend konsiderohet se është ndër vendet më atraktive në Kosovë.

Në studimin e fizibilitetit dhe hartimin e projektit zbatues komunat do të marrin pjesë nga buxhetet e tyre të v. 2024 financimin me nga 20% të kostos financiare.

Nga se u cek si më sipër, i propozoj kuvendit të komunës që t'a miratoj këtë propozim vendim si në dispozitiv.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 47/24
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 23.01.2024
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

K r y e t a r i

Sheshi "Ahmet Krasniqi"nr. 10 ,     Tel.038/200 42402,     E-mail: ferit.idrizi@rks-gov.net

| | |
|---|---|
| PËR/ZA/TO: | Kuvendin e Komunës |
| CC | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH | |
| NGA/OD/FROM: | Për **Ferit Idrizi**<br>Kryetari i Komunës |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Nismë për bashkëpunim ndër komunal në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe komunave: Mitrovicës së Jugut, Obiliqit, Prishtinës dhe Podujeveës |

---

Të nderuar anëtar/e Kuvendit,

Realizimi i projekteve me interes të përbashkët në mes të komunave të Kosovës është paraparë me dispozitat e Ligjit për Bashkëpunim Ndër komunal Nr. 04/L-010 (Gazeta Zyrtare e Republikës Nr. 7/10 Gusht 2011).

Me qëllim të nxitjes së bashkëpunimit ndërkomunal me interes të ndërsjellë për projekte të ndryshme që do të gjenerojnë zhvillim dhe prosperitet për qytetarët, propozoj që kuvendi të miratoj këtë nismë për bashkëpunim ndërkomunal me komunat e cekura si më sipër.

Në kuadër të projekteve të përbashkëta me komunat e sipërpërmendura, propozoj që të miratohet vendimi për financim të përbashkët të **studimit të fizibilitetit si dhe hartimit të projektit detaj/zbatues për ndërtimin e rrugës: Barilevë-Kozaricë-Dumnicë e Epërme-Kunovik-Vesekoc-Kurillovë-Bajgorë.**

Në shtojcë ju dërgojmë propozim vendimin për këtë projekt, për shqyrtim dhe miratim.

Me respekt!